



REVISTË SHKOLLORE E M.M. "ALAUDDIN" PRISHTINË



Nr. 44 / Qershor 2019

DRITA e نور القرآن KUR'ANIT

www.medreseja.com

HORIZONTI MË I AFËRT



MEDRESISTI SOT ËSHTË NXËNËSI
MË ME PERSPEKTIVË NË KOSOVË



Republika e Kosovës Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës MEDRESEJA E MESME "ALAUDDIN" PRISHTINË



Gjenerata
e 18-të
2016/2019

Takimi
i gjeneratës
2029

وَلَا تُؤْخِرُوا عَنْهَا
وَلَا تُؤْخِرُوا عَنْهَا
وَلَا تُؤْخِرُوا عَنْهَا

"Zoti yt do të japë, e ti do të jesh i kënaqur"

Ed-Duha:5



Përmbajtja:

- 3 Fjala e redaktore
- 4 Derisa të kemi libra, jo, nuk do të vdesim
- 4 deri sa të rrojë njerëzimi, do të rrojë edhe libri
- 5 Horizonti më i afërt
- 5 Hija e padukshme e botës
- 6 Dhurata
- 7 Si më mësoi babai?
- 8 Dëshirat e mia
- 9 Istigfari
- 10 Femra, një lule që Islami i dha ngjyrë
- 12 O Allahu ynë, ruaje Medresenë!
- 14 Intervistë me Sulejman ef. Osmani
- 17 Një realitet
- 18 Vlera e begative të Allahut
- 18 O nxënës i dijes!
- 19 Dashuria e saj
- 19 Ishte e bukur, edhe pse...
- 20 Mos u dorëzo
- 20 Jeta
- 20 Një fëmijë dhe një laps ndryshojnë botën!
- 21 Sot
- 21 Jeta i ngjan trëndafil
- 21 Adoleshenca
- 22 Mendoj se asgjë nuk është e pamundur
- 22 Nuk është fundi
- 22 Dhembje që bashkon
- 23 Rruga që kam zgjedhur
- 23 Sikur vetëm edhe një herë...
- 23 E dashur Medrese
- 24 Do ta arrish qetësinë
- 24 Mbi nxënësit
- 25 "Wake up and listen to yourself"
- 25 Life happiness
- 26 Yoksun burda
- 27 A të kam folur ndonjëherë për Medresenë?!
- 27 Vitet në Medrese
- 28 Medreseja
- 28 Medresiste
- 29 Rruga që kam zgjedhur
- 29 Pse zgjodha Medresenë?
- 29 Sekretet e fundit
- 30 Thëniet e maturantëve
- 38 Poezi
- 40 Aktivitete
- 53 Një ditë ku zemrat trokasën ndryshe
- 54 Udhëtimi në Turqi
- 55 Udhëtimi më i bukur në jetë
- 56 Poezi
- 61 Kuriozitete
- 62 Life and personality quotes
- 64 Fjalëformime

Fjala e redaktore

Falënderimet dhe lavdërimet i takojnë vetëm Allahut, Krijuesit tonë, për çdo mirësi të Tij, e veçanërisht për mirësinë e të qenit pjesë e kësaj feje!

Përsëritet më të përzierëta qofshin për më të dashurin e Allahut, Muhamedin, a.s., për familjen e tij, për shokët e tij, dhe për të gjithë ata që ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Ringjalljes!

Si çdo fundvit shkollor, edhe kësaj here doli numri i ri i revistës së shkollës sonë.

Pas shumë angazhimeve dhe ambicieve për të reflektuar mirësitë, porositë e Islamit dhe sukseset e arritura të nxënësve tanë, vlerësuam se të jesh nxënës i Medresesë nuk mjafton vetëm me kaq, mirëpo kërkohet të jesh edhe nën ombrellën e shpërndarjes së dritës dhe reflektimit të brendësisë së artë. Pa dyshim se të gjitha këto nuk do të mund të arriheshin vetëm me mundin tonë. Një falënderim i veçantë është edhe për udhërrëfyesit tanë, e që janë profesorët dhe profesoreshat, të cilët nuk kursyen kohën e tyre të çmuar për të qenë më relativë, që kundruall sukseseve tona të reflektojmë të bashkuar.

Ky numër i ri i kësaj reviste dëshmon për atë se përgjegjësia më e madhe në jetë është të jesh besimtar i drejtë, duke i ftuar edhe të tjerët në këtë fe, gjithmonë me drejtësi, butësi dhe moral të mirë.

Ky numër, po ashtu, tregon zellin e nxënësve dhe talentin e tyre përgjatë shkollimit trevjeçar, respektivisht përgjatë këtij viti shkollor.

Nuk harroj të theksoj faktin se vazhdimësia e sukseseve të gjeneratave të njëpasnjëshme i bënë të ndihën krenarë familjen, shkollën dhe vendin e tyre, në përgjithësi.

Në fund, lusim Allahun e Madhëruar që të gjithë nxënësit të kenë shëndet, korrektësi e suksese, dhe uroj që Medreseja të jetë vatrë e diturisë dhe shtyllë e pakontestueshme e shembullit më të mirë në të gjitha fushat e jetës!

Hatixhe Hasani 12/4

Kryeredaktore: **Hatixhe Hasani 12/4**

Redaktor: **Granit Sadiku 12/2**

Anëtarë të redaksisë:

Valton Abdullahu 12/1, Bali Qorraj 12/2, Mirvete Karaliti 12/3, Zejep Nika 12/4, Amir Gashi 11/1, Habib Berisha 11/2, Alma Fetahu 11/3, Aida Hashani 11/4, Muhamed Kaçi 10/1, Erion Pajaziti 10/2, Rejan Maçastena 10/3, Ndrina Zhushi 10/4, Rumejsa Mehani 10/5.

Lektor dhe redaktor letrar: **Besnik Jaha**
Dizajni: **Bashkim Mehani**

E-mail: **redaksia15@hotmail.com**
www.medreseja.com

DERISA TË KEMI LIBRA, JO, NUK DO TË VDESIM

Gjithë çfarë ka lindur në këtë botë, është e përcaktuar ta ketë edhe fundin. Mirëpo, ajo që nuk vdes kurrë është dija.

Mund të pyesni se ku e ka burimin një gjë kaq madhështore.

Përgjigja është: te njeriu.

Secili njeri ka me vete një thesar të çmuar, që e ruan brenda trurit të vet. Mirëpo disa e gjejnë rrugën për te ky thesar, e disa mbesin të humbur. Secili prej nesh është i përcaktuar të mësojë, të gabojë dhe, më kryesorja, ta bartë me vete dijen.

Eh, libri. Ai është gjeniu i vërtetë. Aty mund ta gjeni përgjigjen e kërkuar prej kohësh. Është ai që bën rezistencë ndaj injorantit, sepse e fuqizon çdo qelizë të trurit. Siç është paraia fuqi fizike, libri është fuqi shpirtërore. Aty ka një fuqi hipnotizuese.

Është kjo vepër hyjnore që mbajti gjallë shumë popuj e tradita, dhe mësoi shumë breza. Ta ruajmë librin, që ta ruajmë veten! Sepse ai është një xhevahir që mban në jetë çdo të verbër.

Esma Qestaj 11/4

DERISA TË RROJË NJERËZIMI, DO TË RROJË EDHE LIBRI

Libri. Një fjalë e thjeshtë për t'u thënë, një gjë e thjeshtë për t'u parë, mirëpo një brendësi madhështore e quajtur dituri. Shpesh e pyes veten se, si edhe pas gjithë këtij zhvillimi në botë libri po e zë vendin më madhor, dhe prapë nuk mund t'i vihet asnjë konkurrent?! Përgjigja nuk ngurron dhe hapet në mua: Pas gjithë këtij zhvillimi, vendin meritohet, dhe ai që qëndron në fron, është libri. Sepse në çdo labirint të vështirë që na del para, rrugën deri në fund, deri te drita në të cilën ka sukses, mund të na e tregojnë vetëm librat.

Dhe, e them pa pikë dyshimi, se deri sa të rrojë njerëzimi, do të rrojë edhe libri.

Vesa Mehani 11/4

HORIZONTI MË I AFËRT

Udhëtim i gjatë ky udhëtimi i njeriut. Që të gjithë e njohin, mirëpo fundin nuk e dëshirojnë. E gjatë kësaj rruge, që fundi nuk i dihet, njeriu mendon. Mendon dhe hesht. Hesht për atë që nuk e di, pasi ajo ia ka lidhur gjuhën. Sheh sa ia arrin syri. Nuk mendon më larg sesa që sheh! Nuk sheh më larg sesa mendon! Dhe nuk lodhet. As për fundin, e as për pasfundin!

Pse e harron Atë që një ditë do ta takojë?! Dhe shpesh ndalet. Nuk mund të vazhdojë. Zemra i dhemb. E lëndon shumë. Dëshpërohet, mirëpo nuk e di pse. Ç'është ajo që e vret aq shumë? Aha, është injoranca, që mbi kokën e tij kishte rënë prej kohësh. Është po ajo, çelësi i errësirës. Është kafazi i atij zogut që krahët i janë ngrirë. Dhe në fund shikon lart. Qielli po e pret. Nuk është koha e duhur, mendon. Asnjëherë nuk do të jetë. Mirëpo, edhe kur dëshpërimi arrin kulmin, mos u dorëzo! Edhe atëherë mund të të mbulojë mëshira.

Aida Hashani 11/4

HIJA E PADUKSHME E BOTËS

Bota. Një sfidë. Apo vetëm një periudhë kohore, të ju them më mirë.

Disa njerëz nuk e perceptojnë dot se çka do të thotë "e pakufishme", sepse mbyllën në atë konceptin se bota është në duart e tyre, mirëpo realiteti nuk është ashtu.

E, për të qenë realist, duhet t'i dish të vërtetat. Për ta njohur të vërtetën, duhet të kesh kohë për ta mësuar atë, dhe, sigurisht ta jetosh. Të vërtetat ekzistojnë. Ato nuk zhduken kurrë. Vetëm fshihen.

Ndonjëherë kjo jetë na bëhet rutinë. Mirëpo, ti jetoje atë si një mundësi që ta dha Krijuesi yt!

Elma Salihu 11/4



DHURATA

Para miliona vjetësh njeriut iu dha një dhuratë. As nuk shihet, as nuk preket, as nuk shijohet, as nuk ka erë, dhe prapë është “oksigjeni” përmes të cilit ne shohim, prekim, shijojmë dhe nuhasim.

Luftëra..., luftëra..., vrasje..., plagosje..., nënçmime e poshtërime. Dikur, kur u pa se qenia e këtyre prota e antagonistëve po keqpërdoret, u shpall se ishin totalisht të pavlefshëm, saqë meritonin as të mos të dilnin para syve të Atij! Eh, ç’të ndodhte tjetër, përveçse u vendos që të përfundonte kjo periudhë vrasjesh e krimesh, dhe të krijohesh një periudhë tjetër. Ajo e “paqes”.

Shkaktari i Pashkak, i pyeti shërbëtorët e Tij: “Ç’tthoni për një krijesë të re?!” Shërbëtorët, paksa konfuzë dhe të dëshpëruar thellë në qeniet e tyre, i thanë: “Nuk duam më gjak.” Shkaktari i Pashkak tha: “Unë jam mësuesi që nxënësit nuk mund t’ia kalojnë.” Pas ca ditësh shërbëtorët, në shëtitje e sipër, panë se një statujë e re kishte dalë në dritë. Nga habia e tyre ata vrapuan shpejt te Shkaktari i Pashkak, dhe i thanë: “Ç’të jetë vallë kjo statujë e re?!” Shkaktari i Pashkak u përgjigj: “Kjo është vepra ime e re.” Një punonjës i ri, që nuk qe shërbëtor, tha: “U sa i pavlerë qenka! Në brendinë e tij po duket se nuk ka asgjë me vlerë. Kështu që, nuk ke nevojë ta çmosh aq shumë një statujë prej balte, të cilën unë mund ta thyej me duart e mia!” Shkaktari i Pashkak u hidhërua në punonjësin e ri, ngase ky i fundit ia përqeshi veprën e Tij delikate, prandaj edhe i tha: “Ti je i pushuar nga puna! Dhe je prej atyre që nuk i dua.” – “Mos! Mos, të lutem (ra në gjunjë punëtori i ri)! Të lutem, mos! – “Ti e tregove veten.”, - i tha Shkaktari i Pashkak.

Punonjësi u mërrol dhe doli nga kontrolli, dhe si rezultat i kësaj filloi t’i thoshte Shkaktarit të Pashkak: “Pasi Ti më bërë mua armik, atëherë edhe unë do ta bëj armik këtë vepër tënden!” Shkaktari i Pashkak e pyeti: “Si do t’ia bësh?!” Punonjësi tha: “Ajo që do të bëj është: “do ta pres e do ta pres, deri deri kur të arrijë në momentet e lumtura të tij. Pastaj do ta zë, dhe do ta bind me mënyrat e mia.” Shkaktari i Pashkak e pyeti prapë: “Si do t’ia bësh?!” Punonjësi i tha: “E di shumë mirë se Ti këtë vepër e do shumë më shumë sesa ne, ngase e krijove me dashurinë Tënde, dhe ia dhe jetën prej Vetes. Nëse ta ofendon dikush, të vjen keq. Nëse kjo vepër e jotja do të ta kthente shpinën, do të bëheshe xheloz. E di shumë mirë se si ia fute shpirtin në atë pjesën e trupit të cilën Ti e di se unë e di se ku është!” Shkaktari i Pashkak e pyeti: “Ku qenka ajo pjesë, o i mallkuar?!” Punonjësi ia ktheu: “Koka, mendja, të mundësuarit..., mendimet. Ajo pjesa që rri lart, e nga lart e lëvizë gjithë trupin.”

Shkaktari i Pashkak u hidhërua edhe më shumë nga këto fjalë që punonjësi i nxirrte nga goja e tij. Punonjësi, kur e pa se e kishte hidhëruar Shkaktarin e Pashkak, i tha: “Të hedhim bast! Nëse unë e mposht këtë vepër Tënden, fitoj, e nëse unë humbas, Ti dhe vepra jote fitoni. Dhe këtë pakt të mos e dijë askush përveç meje dhe Teje!” Shkaktari i Pashkak tha: “Copëzat e dheut të veprës Sime janë të shpërndara. Dikë do ta shkelësh me këmbë. Dikë do ta zbusësh me ujë, mirëpo kur të të mblidhen shumë copa, dhe të të mbulojnë, do të ta zënë frymën! E, sa i përket kësaj ngjarjeje, ata që dinë të lexojnë në rrugën e mesme, ata do ta shohin e lexojnë nëpër shumë libra, po me kohë do ta kuptojë secili.”

“Hahahahahahaha!” -, qeshi me zë punonjësi, dhe bërtiti: “Fitova! Fitova!” Shkaktari i Pashkak e pyeti “Ç’fitove?!” Punonjësi i tha: “E fitova bastin. Tani vetëm sa m’i kujtove dy metoda që veprën tënde ta mund: koha dhe mendja.” Shkaktari i Pashkak qeshi pakëz, dhe tha: “Më dhimbesh që s’e di as këtë gjë! Nuk do të ecin të gjithë me kohën. Ata që më duan Mua, ata do të ecin me devotshmërinë. Mua do të më duan ata që ty të urrejnë.” Punonjësi u ndal, dhe me ironi tha: “Le ta shohim, pra, a do të ecin me kohë, apo me devotshmëri.”

Lexues, dëgjues, e mbi të gjitha mendues i dashur! Para miliona vjetësh njeriut iu dha një dhuratë. As nuk shihet, as nuk preket, as nuk shijohet, as nuk ka erë, dhe prapë është “oksigjeni” përmes të cilit ne shohim, prekim, shijojmë dhe nuhasim.

Cila është kjo dhuratë? E dini ç’është?!

Ajo që nëpër vepra të shumta tregohet se gjendet me shumë punë e përkushtim. Ajo është shkaku që pakkush e kupton se si i zgjidh problemet tona.

Shpeshherë kemi menduar se koha na ka shëruar dhembjet, mirëpo jo, na i ka shëruar mendja jonë e devotshme, e cila edhe në problemet më të mëdha, ka ditur të preokupohet me gjëra të tjera.

Koha nuk shëron. Ajo i sëmur viktimat e saj.

As ti, as unë, as askush, nuk mund ta zhduk kohën. E as ta bëjmë mendjen të ndërrojë 60 herë në 3,600 herë të tjera, e 3,600 herë të tjera në 1,260,000 të tjera, e as 1,260,000 të tjera në 12mil. 960 000 të tjera. Ne mund t’i kombinojmë të gjithë këta sekonda, me mendjen dhe devotshmërinë tonë.

E dini se kush është koha?! Është përpjekja gjashtëdhjetëherëshe në minutë e djallit për të na e ndryshuar bindjen tonë, dhe për të na e larguar mendjen nga devotshmëria!

SI MË MËSOI BABAI?

Kam filluar të merrem me punët e fshatit që në vegjëli të hershme, por jo edhe aq i vogël sa vëllezërit e mi më të mëdhenj. Së pari fillova të merresha me përkujdesjen e bagëtive, mirëpo këtë e bëja vetëm kur vëllezërit e mi ishin në shkollë. Kështu fillova pak nga pak t'i futesha botës së punës, e ndonjëherë kur kishim për të punuar shumë, babai na i ndante punët secilit, dhe mua më së shpeshti më binte ndonjë punë e vogël dhe shumë e lehtë.

Më kujtohet nga fëmijëria që axha im, më i moshuari në familje, para se të emigronte në Gjermani, punonte në një sharrë, e që e kemi në oborrin e shtëpisë. Sharra shërbente që lisat e mëdhenj t'i bënte dërrasa, dhe unë shpesh, pasi kthehesha nga shkolla, një kohë të gjatë rrija aty duke e shikuar axhën se si i sharriste lisat. Aty kënaqesha duke e shikuar punën e sharrës, dhe më dukej krejt normale zhurma që bënte sharra, e që për të tjerët ishte torturë, ndërsa mua më tingëllonte si muzikë.

Njerëzit e tjerë i binin lisat tek axha, që ky tua sharriste me pagesë. Ndodhte shpesh që disa nuk kishin mundësi të paguanin, e axha prapë ua kryente punën, me fjalë që kur të kenë mundësinë t'ia bënin pagesën. Po të shkosh te shtëpia e axhës, edhe sot mund ta gjesh në dollapin e tij një fletore në të cilën janë të shënuar..., epo nuk po vazhdoj më tutje se e dini për çfarë po flas.

Sidoqoftë, axha punonte edhe me traktor. Duke punuar arat, ai edhe nxirrte disa para, dhe me ato mjaftohej. Krejt vonë, siç e kuptojmë çdo gjë ne shqiptarët, edhe axha im e kuptoi se duhej të dilte e të punonte jashtë shteti, se vendi ynë nuk ish që na bënte ikramin të gjithëve.

Pas tij ishte edhe axha i vogël, i cili i kishte më pak se 25 vjet, e që pas tij i punonte të njëjtat punë. Madje, sa herë që e shikoja, damarët e gjakut në duart e tij ishin të ënjtur nga puna e rëndë. Sepse lisat ishin të rëndë, dhe kë ishte me shtat të ligë. E shikoja se si mendohej t'i kapte ata trupa lisash, dhe më dukej se i ndihmoja duke i vetëm me shtrëngimin e dhëmbëve që e bëja në vete. Madje, një herë gati sa nuk i theva dhëmbët. Kështu mundoheshin të mbi-jetonin. Megjithatë, për dallim nga axha i madh, ky provoi dhe shkoi deri në Prishtinë për të studiuar Histori. Epo, aq keq na i kishte ngatërruar punët djalli, sa me studime nuk mundëm të vazhdojmë jetën këtu. Edhe ky axhë mori rrugën e mërgimit, dhe iku të jetojë jashtë shtetit.

Babai im gjithmonë ka punuar si profesor. Jep mësim në një shkollë të mesme të qytetit tonë të skajshëm. Jep mësim për punimin e drurit. Aq është i dhënë pas profesionit, sa bashkë me një axhë timin patën punuar me dru gjithë tavanin e odës së burrave. Aq të veçanta ishin ato zbukurime, sa po t'i shohësh edhe sot, kur teknologjia na ka burgosur në qenien tonë, do të çuditeshit se si kanë mundur t'i punojnë ashtu, në ato kushte të dobëta.

Mendoj se edhe unë këtë gjë e kam të trashëguar prej



tij. Ai, ose duke e shikuar shumë kur punonte, më mësoi edhe mua. Jam mësuar dhe di të punoj aq mirë me produkte druri, sa tani e mahniti edhe babanë tim.

Babai gjithmonë na thoshte (mua dhe vëllezërve të mi), se duhet të mësonim shumë, sepse pa mësim nuk do të bënim një jetë të mirë; se duhet të punonim shumë, që të bënim gjërat tona vetë, sepse vetëm atëherë njerëzit do të na donin më fort, dhe do të na respektonin më shumë. E, nganjëherë kur isha vetëm me të, babai më thoshte: "Puna e përpunimit të drurit është si puna e prindit me fëmijën. Sikurse nga druri që heqim copëza që ta bëjmë ndonjë punim të shkëlqejë, ashtu edhe prej fëmijëve dëshirojmë t'i heqim cilësitë jo të mira, që të shkëlqejnë. Të jesh përpunues i drurit dhe të jesh prind është gati e njëjta gjë. E sheh?", - më pyeste në fund, e unë në shenjë pohimi e lëvizja kokën, ngase mahnitesha me urtësinë që kishte. Epo, siç thoshte edhe ai shpeshherë, jeta e kishte mësuar të mos gabojë kurrë dy herë.

Urtësinë e babait e kuptoja edhe nga puna me drurin. Sidomos këtë fjalinë e fundit. Sepse druri në të cilin mund të gaboje gjatë përpunimit nuk mund të përmirësohej. Pra, në punën me dru ke vetëm një mundësi. Njësoj sikurse me jetën. Unë, edhe pse shumë herë e kam dëgjuar se macja i ka nëntë shpirtra, besoj shumë se e ka vetëm një. Njëherë e kam parë një person teksa shtypi një mace me kamion, dhe e pashë se e kishte pasur vetëm një shpirt. Ai i pashpirti as që u ndal të shikonte se ç'kishte bërë.

Sidoqoftë, unë gjithmonë jam munduar të punoj si babai im. Dhe të jetoj si ai. E di se asnjëherë nuk kam mundur të punoj aq fort sa ka dashur e punuar babai. Mirëpo, ju betohem se gjithmonë kam jetuar siç ka dashur ai: ndershëm dhe me punë.

Armend Kolica 12/2

DËSHIRAT E MIA

Siç dihet, çdo njeri ka dëshira. Një prej tyre jam edhe unë. Dhe, kur bëhet fjalë vetëm për dëshirat e mia, ato janë si një pikë e vogël në universin e pafund në krahasim me dëshirat e të gjithëve, edhe pse nuk na duket ashtu. Shpeshherë, duke shfletuar mendjen, gjej kujtime të bukura, të paharruara, e që kam dëshirë t'i përsëris edhe sot. Mirëpo, nuk është çasti i duhur, dhe për arsye të ndryshme. Megjithatë, mendoj se dëshirat mund të realizohen, përveç atyre që mund të quhen "dëshira mbinatyrore". Nëse mendoni se koha ka ndryshuar, dhe tani nuk mund të realizoni dëshirat tuaja, atëherë gaboheni. Koha nuk ndryshon, por të vetmit që ndryshojmë jemi ne, njerëzit.

Të shkruaj për dëshirat e mia, nuk besoj se dikujt do t'i bëj shumë përshtypje. Megjithatë, do të shkruaj. Mirëpo, së pari më duhet të jem falënderues se jam mirë, sepse kjo do të ishte dëshirë e madhe po mos të kisha qenë i sëmurë! Pra, duhet të jemi falënderues! Falë Zotit po jetojmë në një kohë lirie, dhe barazia është (gati) në nivel, kështu që mund të vrapojmë edhe pas dëshirave! Madje edhe unë!

Po ta shkruaja një listë me dëshirat e mia, nuk do të ishte aq interesante. Kjo është arsyeja pse unë tani nuk do të shkruaja vetëm për ato që dua, por edhe për ato që kam.

Dëshira që ka çdo njeri, e mes tyre edhe unë, është dashuria. Të ofrojmë dashuri, dhe të marrim dashuri! Kështu deshi edhe Zoti qëkur se e krijoi Ademin dhe Havanë. Ata dy e donin njëri-tjetrin. Ndryshe nuk do të ekzistonte njerëzimi. Dashuria është njëra ndër pikat më të ndjeshme të shpirtit tonë.

Edhe unë, si çdo njeri normal, me asgjë të jashtëzakonshme, dëshiroj të kem dashuri për të ofruar, dhe të më ofrojnë dashuri. Dashuria nga familja, shoqëria, apo edhe

dashuria mes dy personave, janë pika të vlefshme që duhet t'i kushtojmë shumë rëndësi.

E bukura jetë do që të plotësohen të gjitha dëshirat. Ne na mjafton të duam. Dhe, ka diçka që unë dua shumë. Është një dëshirë e fortë imja, e që më vjen nga pika më e thellë e shpirtit, dhe që dua ta them edhe këtu, vetëm për hatrin tënd (po po, për ty që po e lexon), pra është të mos ketë luftëra. Nuk i dua luftërat, krimet, trafikimet e qenieve të gjalla njerëzore, apo diçka të këtij lloji. Arsyeja e vetme e këtyre që i përmenda më lart është se bërësit e këtyre veprimëve ndoshta nuk kanë provuar të bëjnë mirë dhe të duan, dhe prandaj bëjnë të kundërtën. Vullneti dhe forca bëjnë që çdo dëshirë të realizohet. Dua të them se duhet të mendojmë të mos rrimë kot, sepse për çdo sekondë, madje edhe ky që po ikën tani taksa unë po shkruaj e ti po lexon, ka vlerë.

Me një fjalë, të mos humbim kohë kot! Ti ndjekim dëshirat dhe ëndrrat tona! Të vrapojmë pas tyre, sepse është shumë e dhembshme të flasësh në heshtje me vetën për atë që dëshiron ta kesh e nuk e ke. Shpeshherë natën, duke parë lakuriqësinë e natës dhe qiellin e hapur, mendoj se duhet të veprojmë shpejt për të realizuar dëshirat tona, sepse nuk do të ketë gjithmonë kohë të bëjmë krahasime. Pra, dëshirat tona janë një grimcë, krahasuar me ato të të gjithëve. Nuk është e vështirë t'i realizojmë dëshirat tona, më besoni! Më e vështirë është ta dimë se ç'farë duam. Dhe, kur e dimë, dhe kemi vullnet dhe forcë, ëndrra e realizuar na zgjon nga gjumi. Tërë këtë që e thashë, po e përfundoj një fjali: "Koha nuk pret që t'i realizosh dëshirat e tua, prandaj duhet të vraposh drejt tyre sa më parë, sepse ajo ikën dhe nuk kthehet kurrë më!"

Bali Qorraj 12/2



ISTIGFARI

Istigfar domethënë të kërkoshe falje tek Allahu, xh.sh., duke thënë estagfirullah për çdo herë kur gabojmë, po edhe kur nuk gabojmë. Pra, është premtim i Allahut të Madhërishëm që kur dikush të bëjë istigfar, kur dikush të kërkojë falje tek Allahu, xh.sh., Ai do t'ia hapë rrugët e suksesit në të gjitha aspektet e jetës.

Përsosmëria te njeriu është e pamundur. Të gjithë njerëzit gabojnë dhe kanë mangësi, përveç pejgamberëve të Allahut, të cilët ishin të vetmit që qenë të mbrojtur. Zoti ynë është Mëshirues dhe më i Dituri për gjendjen e robërve të Vet. Ai e di me saktësi se robërit e Tij janë të dobët, të mangët, e të pafuqishëm, dhe për këtë arsye ua hap derën e shpresës në mëshirën dhe faljen e Tij, duke ua mundësuar sitigfarin. Ai thotë: "Allahu, me mirësinë e Tij, ju thërret në Xhenet e falje." (El Bekare: 221).

Kurse, në një hadith kudsij, që përcillet prej Muhamedit, a.s., transmetohet se Allahu xh.sh. ka thënë: "O robërit e mi, ju bëni mëkate natë e ditë, kërkon falje tek Unë, që t'ju fal!"

Mëkatet janë si zinxhiri i varur në qafën e gjynahqarit, dhe nuk zgjidhet prej aty përveçse me anë të pendimit dhe istigfarit. Falja e mëkateve është begati dhe mëshirë e madhe e Allahut për robin. Epo, kush mundet t'i falë mëkatet tona, përveç Allahut?! "E kush i fal gjynahet, përveç Allahut?!" (Ali Imran: 135), thotë Allahu, xh.sh.

Nëse te një popull shtohet istigfari, dhe ai buron prej zemrave të singerta, Allahu prej atij populli do t'i largojë sprovat dhe ndëshkimet, si dhe do t'i mbrojë nga çdo e keqe.

"Allahu nuk do t'i ndëshkojë ata, përderisa ti ishe në mesin e tyre. Dhe Allahu nuk do t'i ndëshkojë ata, përderisa ata i kërkojnë falje Atij." (El Enfal: 33).

Me shpeshimin e istigfarit zbret edhe mëshira e Allahut: "Përse nuk kërkon falje (të gjynaheve) tek Allahu, që të mund të mëshiroheni?!" (En Neml: 46).

Mëkatet falen edhe po të jenë sa shkuma e detit. Pra, nuk bën të dëshpërohem, e ta humbasim shpresën në Zotin. Ai që ka bërë shumë mëkate, le ta dijë se falja dhe mëshira e Allahut janë shumë më të mëdha sesa mëkatet e tij!

Mangësia është veçori e njeriut. Për këtë Muhamedi, a.s., thotë: "Po që se nuk i bëni mëkate, Allahu do t'ju zëvendësonte me një popull që do të bënte mëkate, dhe që



do të kërkonte prej Allahut falje, e që Ai t'ua falte."

Istigfari (kërkim falja) është ilaç i dobishëm dhe i suksesshëm për pastrim nga mëkatet. Prandaj, Muhamedi, a.s., ka porositur: "O ju njerëz, pendohuni tek Allahu, dhe kërkon falje tek Ai, sepse unë pendohem tek Ai njëqind herë në ditë!" (Transmeton Muslimi).

I Lartësuar, Zoti ynë, ka thënë: "Të gjithë ju, o besimtarë, kthehuni tek Allahu të penduar, që të arrini shpëtimin!" (En Nur: 31)

Istigfari është shkak që të shpëtosh prej dënimit të Allahut, xh.sh., prandaj Ai nuk dënon ata që i kërkojnë falje. Ai që bën shumë istigfar do t'i jepet pema më e mirë e Xhenetit, e cila quhet Tuba. Pejgamberi, a.s., thotë: "Tuba do të thotë jetë për atë që gjen në regjistrin e tij istigfare të shumta." (Transmeton Ibën Maxhe: 3950).

Vlera e Istigfarit

Vlerën e istigfarit e kam përmbledhur në disa pika, si në vijim:

1. Është adhurim, me të cilin i afroresh Allahut;
2. Është shkak për faljen e gjynaheve. Allahu, xh.sh., thotë: "Kërkon falje prej Zotit tuaj, i Cili është Falës i Madh!" (Nuh: 10);
3. Është sebeb për zbritjen e shiut. Allahu, xh.sh., thotë: "Që Ai t'ju dërgojë shi të bollshëm." (Nuh: 11);
4. Është sebeb për shtimin e pasurisë dhe të fëmijëve. Allahu, xh.sh., thotë: "T'ju shtojë pasurinë dhe fëmijët tuaj." (Nuh: 12);

5. Është sebeb për furnizimin me kopshte dhe me lumenj. Allahu, xh.sh., thotë: "Dhe të bëjë për ju kopshte e lumenj!" (Nuh: 12);

6. E shton fuqinë në të gjitha aspektet. Allahu, xh.sh., thotë: "Dhe do t'ju shtojë fuqi mbi fuqinë tuaj." (Hud: 52);

7. Është sebeb për shijimin e kënaqësive të bukura. Allahu, xh.sh., thotë: "Ai do t'ju japë të shijoni kënaqësi të bukura". (Hud: 3);

8. Është sebeb për largimin e belave. Allahu, xh.sh., thotë: "Allahu nuk do t'i ndëshkojë ata, përderisa i kërkonjë falje Atij." (El Enfal: 33);

9. Është sebeb për ta fituar çdo njeri atë që e meriton. Allahu, xh.sh., thotë: "Dhe do t'ju japë çdo të miri shpërblimin e merituar." (Hud: 3);

10. Është sebeb për zbritjen e mëshirës. Allahu, xh.sh., thotë: "Përse nuk kërkonit falje (të gjynaheve) prej Allahut, që të mund të mëshiroheni?!" (En Neml: 46);

11. Është sebeb për shpagimin e mexhlisit (tubimit);

12. Njerëzit janë më së shumti nevojtarë për istigfarin, ngase ata mëkatojnë për çdo ditë e natë, dhe nëse robi i drejtohet Allahut me kërkimfalje, Allahu do t'ia falë atij!

13. Është sebeb për pasimin e të Dërguarit të Allahut, lavdia dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, ngase ai, s.a.v.s., kërkonte falje tek Allahu shtatëdhjetë herë në një mexhlis. E, sipas një transmetimi tjetër, deri në njëqind herë.

Allahu për hir të istigfarit na i plotëson shumë dëshira. Njëherë dijetarin e shquar Ahmed bin Hanbel, duke udhëtuar e zuri nata në rrugë. Ai shkoi te një xhami, e fali jacinë, dhe deshi të rrinte e ta kalonte natën në xhami. Mirëpo rojtari i xhamisë as që e njohu, dhe nuk e lejoi. Ai, duke kërkuar konak që ta kalonte natën, e takoi një bukëpjekës. Ai e mori, dhe shkuan bashkë te furra. I përgatiti vendin për të pushuar, dhe filloi punën. Ai, duke punuar pa ndërprerë, thoshte: "Estagfirullah!". Imam Ahmed i tha: "O vëlla, ti shumë po bën istigfar." Bukëpjekësi ia ktheu: "O vëlla, mua Allahu, për hir të istigfarit, m'i ka plotësuar të gjitha dëshirat, përveç njëres." Imami tha: "E cila është ajo që nuk të është plotësuar?" Ai tha: "Ka moti që i lutem Zotit të më takojë me Imam Ahmedin, po s'po kam fatin ta takoj." Imami tha: "Po, pse do ta takosh atë?" Ai i tha: "Dua të takohem me të, se ai është dijetar shumë i urtë." Imami tha: "Myzhde, se për hir të istigfarit Zoti ta ka pranuar lutjen! Unë jam Imam Ahmed." Atëherë njeriu u gëzua shumë, dhe e falënderoi Allahun për këtë mirësi.

Siç e pamë gjer tani, arkitektura më madhështore në këtë dynja është ndërtimi i urës së istigfarit mbi detin e mëkateve. Allahu ia bëri të mundur atij njeriu që imami të jetë mysafir i tij, edhe duke mos e njohur atë.

O Zot, na e mundëso që sa më shumë të bëjmë istigfar, dhe na i plotëso dëshirat ne dhe gjithë myslimanëve! Amin! Ja, Rabbel alemin!

Leonora Krasniqi 12/4

FEMRA, një lule që Islami i dha ngjyrë

Të jesh femër është sprovë, po edhe kënaqësi. Është frikë, po edhe lumturi. Është vështirë po bukur. Jemi mësuar shumë herë të dëgjojmë frazat: "jo, se ti je femër", "është turp, se ti je femër", "mos fol, se je femër" etj. Megjithatë, këto fraza zakonisht thuhën prej injorantëve që ende s'e kuptuan rëndësinë e femrës, apo që ende mbetën në kohën e injorancës.

Po, si e sheh Islami femrën?

Të kthehemi pak te koha para ardhjes së Pejgamberit a.s. Atëherë kur femra varrosej e gjallë. Atëherë kur vinte në jetë fëmija, diskutohej se a ishte femër, apo fëmijë. Atëherë femra diskutohej se a ishte njeri, apo jonjeri. Në atë kohë femra përdorej si objekt: shitej e blihej, dhe përdorej siç dëshironte pronari; edhe varrosej e gjallë dhe askujt nuk i interesonte! Ishte thjesht një objekt që përdorej prej meshkujve.

Në Indi femra e ve digjej së bashku me trupin e vdekur



të burrit. E po të shpëtonte nga rastësia, i ndalohej rreptësisht martesë me një burrë të dytë.

Ajo nuk kishte asnjë të drejtë, qoftë shoqërore, ekonomike, politike a kulturore. Ajo, në fillim i nënshtrohej babit, e pastaj burrit, dhe në fund edhe fëmijëve.

Erdhi mëshira, rahmeti për mbarë botën. Përkrahësi i krijesës që me gjithë butësinë dhe mëshirën e saj trajtohej si objekt. Erdhi Islami, që i dha femrës të drejtën njerëzore, fetare, etike, arsimore, ligjore etj.

Atëherë kur femra varrosej e gjallë, erdhi ajeti i Zotit të Gjithëmëshirshëm, e ku thuhej:

"Kur ndonjëri prej tyre lajmërohet me (lindjen) vajzë, fytyra e tij prishet dhe bëhet plot mlllef."

Pastaj Pejgamberi, a.s., kumtoi ndalesën për mbytjen e vajzave, e cila erdhi nga qielli. Zoti, xh.sh., thotë: "Dhe kur të pyeten ato vajza të varrosura të gjalla se për çfarë mëkati ato janë mbytur."

Pra, gjithsecili që e ka varrosur vajzën e tij, do të pyetet për arsien, e që pa dyshim se do të jetë e papranuar te Zoti.

Të fillojmë që nga mbulesa e saj. Zoti e privilegjoj femrën me mbulesë. Rreth kësaj një hoxhë i nderuar thotë: "Arsyeja pse femra mbulohet është për të ruajtur nderin dhe moralin e saj, ngase femra vetvetiu është tërheqëse. Diamantin, thotë ai, pse e ruajnë me roje siguri? Ngase është i shtrenjtë. Gruaja është më e shtrenjtë se diamanti."

Ky krahasim lavdëruar që i bëhet femrës nuk është gjë tjetër veçse fjalë që femra i meriton. Respekti që Islami ia ofron femrës, qoftë kur ajo është vajze, pastaj grua, si dhe nënë, nuk ia ofron askush tjetër. Kur ajo është vajzë, dhe edukohet në mënyrë të mirë prej prindërve, ajo është xhenet për prindërit e saj. Pejgamberi, a.s., thotë: "Ai që rriti tri vajza, i arsimoi dhe i edukoi ashtu siç duhej, dhe i trajtoi mirë edhe pas martesës së tyre, ka fituar Xhenetin."

Pra, së pari si vajzë ajo ua jep prindërve xhenetin. Ndërsa, fetë e tjera nuk i respektojnë e as nuk ua japin këto të drejta femrave. Për shembull, hebrenjtë për gruan thonë: "Një grua, mendja, gjuha dhe trupi i së cilës është në nënshtrim (të të shoqit) do të fitojë më shumë famë në këtë botë, ndërsa në botën tjetër të njëjtin vendbanim me burrin e saj." Pastaj thuhet: "Ditë e natë grua duhet të jetë në vartësi të meshkujve, ngase ajo asnjëherë nuk është e denjë për liri, madje edhe brenda mureve të shtëpisë së saj ajo nuk lejohet të kryejë sakrificat e saj fetare, dhe mund të agjërojë vetëm për burrin e saj."

Shën Pali u drejtohet femrave në këtë mënyrë: "Ju, gratë, nënshtrohuni ndaj burrave tuaj pors i ndaj Zotit, sepse burri është kreu i gruas, sikurse edhe Krishti është kreu i kishës, dhe ai vetë është Shpëtimtari i trupit! Ashtu si kisha i është nënshtruar Krishtit, kështu grati duhet t'i nënshtrohen burrave të tyre në çdo gjë."

Pra, e shohim se femrës nuk i jep të drejtë asnjë fe më shumë sesa Islami, feja e paqes dhe e mëshirës. Duke vazhduar femra rrugëtimin e saj, kalon në pozitën e gruas, e ku edhe këtu, në Islam, femra ka pozitë të veçantë.

Pejgamberi, a.s., ka thënë: "O njerëz! Kini frikë Allahun lidhur me sjelljen ndaj grave!"

Pejgamberi ynë i dashur, salallahu alejhi ve selem, ua tërhoqi vëmendjen burrave në mënyrë qortimi, që të sillen mirë dhe butë me gratë e tyre, sepse me të vërtetë ato meritojnë butësinë.

Pejgamberi, a.s., ishte i sjellshëm dhe i butë me gratë



e tij. Tregon Ibnul Kajjimi, se ai e shtynte Aishen kur ishin duke luajtur, e pastaj ia zinte derën që të mos kalonte jashtë, derisa ajo lodhej dhe e vendoste nifullën mbi supin e Pejgamberit, a.s., e pastaj ai i ndihmonte në kryerjen e punëve të shtëpisë, dhe këtë nuk e konsideronte aspak turp, përkundrazi ai kënaqej dhe nuk e shihte si të metë.

Pastaj, si nënë femra prapë ka përparësi kundrejt burrit. Pejgamberi, a.s., u pyet prej një personi se kë duhej ta respektonte më së shumti, e ai i tha: "Nënë tënde." - "Kush, pastaj", i tha ai. "Nëna jote.", ia ktheu Pejgamberi, a.s. "Po pastaj, kush?" Prapë: "Nëna jote.", i tha. "Po pastaj, kush?", i tha ai. "Pastaj babai yt", i tha Pejgamberi, a.s.

Xheneti është nën këmbët e nënës, prandaj duhet të jemi tej mase respektues ndaj nënës. Ne e kemi mundësinë ta fitojmë Xhenetin, madje edhe në këtë botë. Me respektin që ia bëjmë prindërve, e në veçanti nënës.

Pra, Islami asnjëherë nuk e shtyp gruan. Ai madje i ndan detyrat mes bashkëshortëve, duke ua përshtatur detyrat me fizikun e tyre. Nëse këta i përmbahen detyrave, atëherë gjithmonë do të ketë harmoni dhe lumturi familjare.

O Zot, në më japësh pasuri, mos ma merr lumturinë, dhe në më japësh fuqi, mos ma merr mendjen! O Zot më mëso t'i dua njerëzit ashtu siç e dua vetën, dhe më mëso ta gjykoj veten ashtu siç i gjykoj njerëzit! Amin!

Kaltrina Kosumi 12/3

Hytbeja e fundit

O ALLAHU YNË, RUAJE MEDRESENË!

Falënderimet, lavdet, lutjet dhe ibadetet janë për Allahun, Zotin tonë! Krijuesin e qiejve e të Tokës, si dhe të çdo gjallese brenda saj! Paqja dhe mëshira e Mëshirëplotit qofshin për të Dërguarin e Allahut, Muhamedin s.a.v.s., mësuesin e njerëzimit, atë që na e la trashëgiminë më të mirë, dijen më të dobishme për fenë hyjnore – Islamin; mbi familjen e tij, mbi shokët e tij, dhe mbi çdo trashëgimtar dhe pasues të kësaj rruge të ndritshme, deri në Katakлизëm!

Të nderuar vëllezër! Të dashur bashkudhëtar të idealeve të larta! Po ju drejtohem me pak fjalë, nga ky minber i ndritur, nga ky vend i pastër e fisnik, për ta mbajtur këtë hytbe të fundit të kësaj gjenerate, para këtyre fytyrave të ndriçuara me nurin e besimit e të stolisura me petkun e Islamit!

Ndihem i pafuqishëm të mbledh veten, e ta zgjidh nyjën e gjuhës, që t'ju drejtohem me pak fjalë, po, me lejen e Allahut, dhe me krenari të madhe, sot i dalë para jush,

do t'jua drejtoj disa porosi nga thesaret e çmueshëm të diturisë hyjnore - Kuranit fisnik dhe Sunetit pejgamberik.

Të nderuar vëllezër! Sa të ngazëllyer duhet të ndihemi ne, bijtë e kësaj shkolle, kur dëgjojmë një hadith të saktë të të dashurit tonë, që thotë:

“Kujt Allahu ia do të mirën, ia mundëson të kuptuarit e thellë të fesë!”

A s'ndihemi të mbuluar me mirësitë e Allahut ne si brez, kur e kujtojmë se këtu, në këtë shkollë, kemi vënë hapat e parë drejt kuptimit të fesë?! Këtë hadith ka tre vjet që e kemi dëgjuar, e kemi medituar dhe e kemi jetësuar! Dhe, tash sikur na thërret edhe një herë, që rrugëtimi drejt realizmit të këtij kuptimi duhet vazhduar. Pejgamberi i Zotit, ishte i frymëzuar prej Allahut ta thoshte këtë hadith! Këtë hadith, po ta përkthenim në realitetin e sotëm, do të mund të thoshim: Kujt Allahu ia do të mirën, ia mundëson të jetë medresist! Prandaj, përgëzime për ty, o medresist! Allahu të do ty.



Photo by: Flakon Zharku

Të dashur vëllezër! Ndaluni e mendoni, se kur ne si njerëz të thjeshtë lavdërohem prej njerëzve që kanë pozita të veçanta, qoftë politike, qoftë pozita ekonomike etj., ndihemi paksa të privilegjuar, dhe paksa krekosemi më këtë fakt! Edhe pse e dimë se ai njeri me pozitë të lartë mund të jetë mëkatëtar, dhe doemos se i tillë edhe është, prapë na vjen mirë! Pra, ne prapë mburremi kur ai na lavdëron me fjalët e tij. Po, të dashur, si është puna e lavdërimit prej vetë Krijuesit, Allahut, Zotit tonë?! A nuk duhet të ndihemi të lavdëruar e tejet të kënaqur kur lavdërohem prej Tij?! Prej të Vetmit që meriton lavdinë. Prej Atij që është i Denjë për falënderim. Që nuk lavdëron askënd tjetër, përveç të devotshmëve dhe punëmirëve.

"Dhe përgëzoji ata që besuan dhe bënë vepra të mira!"

"Me të vërtetë Allahu i do të devotshmit."

Nganjëherë pyetja është përgjigja më e fortë! Atëherë, përgëzime për ty, o medresist! Përgëzime për zgjedhjen tënde! Përgëzime për ty, që Allahu ta dëshmoi dashurinë e Tij ndaj teje, duke të të sjellë këtu, në këtë shkollë! Në këto klasë, e në këtë xhami, ku çdo ditë lexohet Fjala e Tij.

Të jesh medresist ka shumë begati! Begatitë më të mëdha janë morali, dituria e dobishme dhe instruksionet e rrugës për në Xhenet. Morali i një medresisti është dukshëm i dalluar, ngase Medreseja na mësoi që kurrë të mos i vëmë interesat personale para atyre kolektive. Na mësoi që të jemi nxënës të mirë, familjarë të mirë, fëmijë të mirë, xhemat i mirë, e mbi të gjitha myslimanë të mirë. Na mësoi se ajo që vihet në theks kur përmenden mungesat në këtë shoqëri është morali, prandaj duhet të kemi kujdes të shtuar për të. Medreseja me ngjason sikur një pemë shtatlartë, frytet e së cilës i vjelim ne, dhe jo vetëm.

Morali e virtyti janë e mira e madhe e kësaj peme. Janë ato që e ruajtën të pamposhtur, ashtu siç është. Medreseja nuk është bërë prej një njeriu. Është bërë nga gjenerata e gjenerata. Medreseja u ngrit me moral, dhe nuk mund të mposhtet nga amoralja! Medreseja është familje, dhe nuk mund të ketë ndjenjë tjetër në të përveçse dashuria si në familje! Të jesh medresist, do të thotë të jesh në shërbim të fesë dhe kombit. Të jesh medresist do të thotë të jesh gjithmonë medresist, pavarësisht drejtimit a profesionit! Moralin na e mësoi Medreseja, të dashur, prandaj ruajeni përgjithmonë!

Begati tjetër e madhe që dhuron kjo shkollë është edhe dituria e dobishme. Kjo dhuratë e madhe që nuk i jepet çdokujt. Kjo dhuratë për të cilën dijetarë, shkencëtarë, letrarë, shkrimtarë kaluan rrugë e rrugë të shumta, dhe pak prej tyre arritën ta gjenin. Ndërsa, medresisti e fiton për çdo ditë një diamant nga ky thesar diamantesh. Pra, nga Medreseja mësuam se dituria e dobishme i duhet patjetër një besimtari, prandaj mos kërkon kurrë dituri tjetër përveç asaj të dobishmes!

Po, begati kryesore e kësaj shkolle janë instruksionet që na i dhanë mësuesit dhe pedagogët e tanë, për rrugën e cila na çon për në Xhenet. Për Xhenetin kanë folur shumë ligjërues, dhe kanë treguar për madhësitë e bukuritë e tij. Po, a ka madhësi më të madhe sesa kur shihet Al-

lahu në Xhenet?! A ka kënaqësi më të madhe sesa të jesh medresist, e ta mësosh formën se si të shkosh në Xhenet, e ta takosh dhe ta shohësh Krijuesin?! Në atë ditë të madhe. Në atë ditë ku harrohen të gjitha brengat e preokupimet e kësaj bote.

Krijuesi, Mbisunduesi i Arshit madhështor do të thërras: "O banorët e Xhenetit, paqja dhe mëshira Ime qoftë mbi ju!" E, xhenetlinjtë nuk do të thonë tjetër përveçse: O Allah, Ti je paqja, dhe prej Teje vjen paqja, i Madhëruar je, o Pronar i madhështisë dhe nderit!

Dijeni të dashur vëllezër se ne sot mbajmë në dorë fanarin shndritës, dritën e udhëzimit hyjnor, dhe me të duhet të ecim pranë njerëzve që ende janë në rrugën e errët e të mbushur me joshje djallëzore. Ata nuk bënë t'i lëmë në errësire, në humbje, dhe nuk bënë të lejojmë që ata t'i ndjekin rrugët e devijuara. Është mision yni t'ua ofrojmë këtë dritë, Kuranin, sepse këtë mision e kishte edhe i Dërguari ynë s.a.v.s.. Allahu tha:

"Allahu e vë me atë (me Kuranin) në rrugët e shpëtimit atë që ndjek kënaqësinë e tij, dhe me ndihmën e Tij i nxjerr ata prej errësirave në dhe i udhëzon në një rrugë që është e drejtë." (El Maide: 16).

Të dashur dhe të respektuar vëllezër! Ju të nderuar pedagogë e mësues! Çdo gjë e ka fundin e vet, përveç Allahut, që është i Pafillim dhe i Pambarim! Ne po dalim dhe do të ecim nga bankat e kësaj shkolle, mirëpo jo, kurrsesi, nuk do të dalim jashtë porosive dhe misionit fisnik të saj! E kuptuam me çfarë na ngarkon ky mision dhe, me ndihmën e Zotit, atë do ta çojmë në vend. Ju që po mbeten këtu, dijeni që një ditë si kjo jona do t'ju vijë shumë shpejtë, po kujdesuni për çdo çast që ju e kaloni në bankat e kësaj shkolle!

Të gjitha këto privilegje e begati duhet të shpaguhen me një çmim. E çmimi i saj është përgjegjësia, përkushtimi me zellin më të lartë ndaj asaj që e kemi mësuar: të urdhërojmë në të mirë, e të ndalojmë nga çdo e keqe!

Të dashur dhe të respektuar nxënës! Ruajeni Allahun, që edhe Ai të ju ruajë! Pasoni hapat e të Dërguarit, se nuk do të humbni asnjëherë! Duhet ta doni Islamin, që të fitoni lumturinë e kësaj dhe botës tjetër!

O Allahu ynë, ruaje Medresenë, dhe ata që na mësuam në të!

O Allahu ynë, forcoji shtyllat e saj, dhe bëje atë të qëndrueshme ndaj çdo fitneje dhe rreziku!

O Allahu i qiejve edhe i Tokës, begatoji nxënësit e saj, dhe përdori ata në adhurim ndaj Teje, si dhe në shërbim të krijesave Tua!

O Allahu ynë, kush na ka mësuar dhe edukuar në këtë shkollë të bekuar, shtoja dijen, dhe ruaje atë dhe familjen e tij, si dhe na bashko me ta në Xhenetin Tënd!

O Allahu ynë, na i fal mëkatet tona në këtë muaj të bekuar! Pranoji adhurimet tona!

Na i mbulo të metat tona, dhe na i bashko zemrat tona!

O Allahu ynë, largoje zilinë dhe urrejtjen nga zemrat tona!

Allahume amin!

Intervista me sekretarin e shkollës, Sulejman ef. Osmani

MEDRESISTI SOT ËSHTË NXËNËSI MË ME PERSPEKTIVË NË KOSOVË

Sulejman ef. Osmani i ka shërbyer Medresesë Alauddin për 36 vjet me radhë, ndërsa këtë vit do të pensionohet

ÇDO GJË QË I KA NDODHUR POPULLIT
SHQIPTAR, I KA NDODHUR EDHE MEDRESESË.

Redaksia: Fillimisht ju falënderojmë që keni pranuar ta bëjmë këtë intervistë! Pyetja jonë e parë është: A mund të na tregoni diçka për fillimet e juaja në Medrese?

Sulejman Osmani: Mendoj se çdo periudhë e Medresesë i ka specifikat, sfidat, po edhe sukseset e veta. Unë personalisht kam pasur fatin të marr pjesë në shumë nga këto aktivitete të Medresesë. Qysh nga viti 1983, kur kam filluar punën time në Medrese, Medresenë e kanë përcjellë një mori ngjarjesh. Sidomos ngjarjet në vitet 1989-99, që për mua kanë qenë vitet më të rënda, po njëherazi edhe më vendim-marrëset për popullin shqiptar. Po, në të njëjtën kohë, edhe Medreseja ka qenë pjesë e pandashme e tyre. Me bindje të thellë them se Medreseja ka qenë fati i popullit. Çdo gjë që i ka ndodhur popullit shqiptar, i ka ndodhur edhe Medresesë. Sidomos kur flasim për periudhën që e përmendëm më herët 1989-99, e që Medreseja e ka luajtur rolin më të mirë të mundshëm. Kjo për shkak se po në këtë periudhë, gjithçka që është bërë rreth Kosovës, rreth problemeve, rreth asaj se çfarë të bëjmë më tutje, e çdo organizim tjetër, është bërë këtu në Medrese. Në atë kohë, flas për vitin 1989, kur popullata largoheshin nga shkollat, puna etj., ne i ndihmonim sipas mundësive tona, qoftë studentët, apo edhe të tjerëve që kanë pasur nevojë. Më kujtohet se në atë kohë patëm pauzuar një muaj. Pra, nuk kemi mbajtur mësim në shenjë revolte për ato krime, dhe presione që po bënte Serbia në vendin tonë. Falë Zotit që Medreseja ka qenë shkollë fetare, dhe e pafinancuar nga shteti i atëhershëm, dhe Serbia nuk ka dashur fare të ketë punë me një institucion siç ishte Medreseja. Pra, ne e kemi vazhduar punën, për të mos u ndalur asnjëherë. Dua ta përmend edhe me këtë rast profesorin Fehmi Agani, që ka qenë koka dhe shpirti i politikës shqiptare. Kam pasur fatin që ta kem profesor, dhe të ndaj shumë gjëra me të, qoftë



sa i përket angazhimeve që bënim, qoftë për shkak të konsultave profesionale dhe të urta që merrnim prej tij. Ai ishte largpamës. E kujtoj mirë kur më pati thënë: "Ky vend duhet ta vazhdojë punën. Ju jeni solidarizuar me studentët, nuk keni mbajtur mësim për një muaj, e keni ndihmuar popullin, mirëpo çështja është se tani ky vend duhet ta vazhdojë punën. Ky vend na duhet." Pra, siç e potencova edhe më herët, qoftë sa i përket universitetit, qoftë sa i përket formimit të partive politike, apo sa i përket Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, më vonë, të gjitha janë mbajtur në ambientet e Medresesë. Ka pasur rreze, ka pasur kërcënime etj., mirëpo ne kemi qenë të gatshëm të përballemi me të gjitha ato sfida. Ne e kemi pasur një parim të njohur për ne: Medreseja është djersa e popullit. Medreseja është e formuar nga sadakaja e popullit, nga zeqati e nga ndihma e popullit. Pra, Medreseja është e popullit.

Ngjarje me shumë rëndësi për Medresenë është edhe vendimi që më 21-22 qershor 1992 të mbahet Kuvendi i Parë i Republikës së Kosovës, po në ambientet e Medresesë. Atë natë, deri në ora 01:00 të mesnatës, kemi qëndruar në Medrese, duke folur për këtë organizim. Pastaj, po në këtë orë na erdhi lajmi se Medreseja po okupohej. Ne vendosëm të rrinim këtu. E pastaj, në ora 03:00 të mëngjesit, u okupua Medreseja, me forca të ndryshme e të rënda. Ajo gjendje nuk mbahet mend të ketë ndodhur më parë.

Medresenë e kanë demoluar, e neve po ashtu na kanë torturuar. Pastaj na kanë marrë në deklaratë, e cila ishte një torturë psikologjike. Pra, ka pasur tortura të mëdha fizike dhe psikike. Kemi qenë gjithherë në shërbim të fesë dhe të kombit. Fillimet e mia, pra, nuk kanë qenë të lehta. Ajo kohë ishte kohë e rëndë, pra si për gjithë popullin shqiptar.

KA QENË SHUMË E VËSHTIRË TË ISHE
MEDRESIST. PUSHTETI I ASAJ KOHE E
NDALONTE ÇDO GJË QË ISHTE FETARE.

Redaksia: Pa dyshim se ajo kohë ka qenë kohë e vështirë për ju, dhe keni qenë të rrezikuar në shumë aspekte. Falë Zotit, ajo kohë ka kaluar, dhe tani nuk e ndiejmë më atë tmerr. Zakonisht, kur e vizitojnë Medresenë, hoxhollarët, profesorët, punonjësit e Bashkësisë Islame, po edhe vetë myftiu i Republikës, Naim ef. Tërnavë, e potencojnë edhe faktin se nuk ka ndjenjë më të mirë sesa ndjenja e të qenit medresist. Mund të na e përshkruani ndjenjën e të qenit medresist në kohën kur ju ishit medresist?

Sulejman Osmani: Unë në Medrese jam regjistruar në vitet 1969 ose 1970. Ajo periudhë dallon prej periudhës suaj tani. Në fakt, në atë kohë ne kemi qenë njerëzit më të urryer. Ka qenë shumë e vështirë të ishe medresist. Pushteti i asaj kohe e ndalonte çdo gjë që ishte fetare. Nuk kemi pasur perspektivë. Mirëpo, ata që mua më motivuan të vija në Medrese ishin prindërit e mi, si dhe imami i fshatit. Këta ishin shtyja ime më e madhe. Nuk mendohej që në atë kohë të regjistroheshim në ndonjë fakultet, për shkak se medresisti në atë kohë nuk mund të regjistrohej në fakultet. Po, ne patëm fat, dhe na ka nderuar Zoti që të vazhdojmë edhe studimet, jo në botën arabe, po në degën e Orientalistikës, në Fakultetin Filozofik, këtu në Prishtinë. Kujtesa për hoxhollarët që i kishim mësues në Medrese është e pashuar. Për shembull, e kujtoj hoxhën e nderuar Sherfi ef. Ahmetin, që ishte prej njerëzve të rrallë. Ai ka pasur aq shumë efekt te nxënësit, sa kishte nxënës që thoshin: "Në Medrese rrimë për hatrin e Mulla Sherifit."

Pra, në atë kohë të ishe medresist ishte shumë e vështirë. Koha jonë, me kohën e nxënësve sot, dallon si nata me ditën. Dhe, falë Zotit, në periudhën e pasluftës, Zoti ia dha Medresesë nderin dhe krenarinë e saj, e që i përkiste shumë kohë më parë. Sot ne jemi të barabartë me të gjitha shkollat e tjera. Po ashtu, lirisht mund të them se medresisti sot është nxënësi më me perspektivë në Kosovë. Për shkak se medresistët janë të barabartë me nxënësit e shkollave të tjera, dhe

FALEMNDERIT ZOTIT QË MA KA MUNDËSUAR
TË PUNOJ NË KËTË VEND! I KAM PËRCJELLË
36 GJENERATA, E PREJ TYRE JANË DIKU
4500 ISH NXËNËS TË DIPLOMUAR.

janë në avantazh për sa i përket njohurive për jetën, si dhe dijet në përgjithësi.

Redaksia: Jeni prej njerëzve që keni dhënë kontribut të madh për Medresenë. Keni punuar për kohë të gjatë këtu. A ka pasur ndonjë moment kur jeni zhgënjyer, apo jeni lodhur së punuari?

Sulejman Osmani: T'ju them të drejtën, jo. Singërisht, nuk ka pasur asnjë rast kur jemi zhgënjyer apo dëshpëruar me punën tonë për Medresenë. Tregova edhe më herët për rreziqet që i kemi pasur, po, pa marrë parasysh sfidave dhe problemeve, nuk jemi ndalur kurrë. Madje, them me gjithë zemër, falemnderit Zotit që ma ka mundësuar të punoj në këtë vend! I kam përcjellë 36 gjenerata, e prej tyre janë diku 4500 ish nxënës të diplomuar. Kurrë nuk kemi pasur asnjë problem me nxënësit. Përkundrazi, për mua ka qenë kënaqësi shumë e madhe.

KAM EMOCIONE KUR FLAS PËR NJË NJERI SI
MUSTAFË VESELI. SIPAS MEJE, ATË NXËNËS
ZOTI E KISHTE PËRGATITUR QYSH NGA
FILLIMI TË ISHTE DËSHMOR I VENDIT.

Redaksia: Përvoja juaj me nxënësit ka qenë e bujshme. Më herët u përmendën edhe ata nxënës që në gjendje lufte i kanë veshur uniformat dhe janë flijuar për lirinë e Kosovës. Një shembull i heronjve që ka pasur Medreseja, e që keni pasur edhe ju kontakte të shpeshta me të, është edhe Mustafë Veseli, që është vrarë në vitin 1989. Mund ta ndani me ne një rast nga përvoja juaj me të, rast që e dëshmon dashurinë e tij për Medresenë dhe atdheun?

Sulejman Osmani: Kam emocione kur flas për një njeri si Mustafë Veseli. Sipas meje, atë nxënësi Zoti e kishte përgatitur qysh nga fillimi të ishte dëshmor i vendit. Dëshirën e tij të flaktë për ta mbrojtur atdheun e tij, fenë, e Medresenë, gjithmonë e vëreje në sjelljen e tij, në çdo rast. Kjo dëshirë e Mustafës u vërtetua edhe më shumë kur organizoheshin protesta dhe demonstrata nga popullata. Ajo që më ka mbe-

MË KUJTOHET MIRË FJALA E NJË STUDENTI
PËR MUSTAFËN: "LUM SHPIJA, LUM
SHKOLLA, E LUM VENDI QË E KA PASUR!"

tur në kokë, dhe nuk mund ta harroj kurrë, është një protestë te salla "1 Tetori". Televizioni i atëhershëm, kur i jepte lajmet, në mbrëmje, e nxirrte Mustafën. E kishte fokusuar kamera për shkak të veshjes që ai e kishte pasur. Kuptohet: kuq e zi. Kjo për ta bërë tërë Jugosllavinë ta kuptonte se çfarë nacionalisti ishim. Ato që më kanë mbetur në memorien time të freskët po ashtu janë edhe çastet e fundit me Mustafën. Ka qenë ditë e hënë, 23 marsi i vitit 1989. Ai gjatë fundjavës kishte qenë në shtëpi, e të hënën kishte ardhur. Duke ardhur me autobus, policia serbe i kishte larguar nga autobusi, duke ua ndaluar të vinin në Prishtinë. Mustafa nuk ishte nënshtruar ndaj këtij urdhri, dhe kishte ardhur në këmbë deri në Medrese. Ai shkoi të pushonte lart në konvikt, dhe unë, kur e pashë fytyrën e tij të dëshpëruar, ngase vërehej që ishte i thyer, i thashë: "Çfarë ka ndodhur, Mustafë, kështu?" Më tha: "Hoxhë efendi, punët nuk i kemi mirë. Prej asaj që unë pashë sot, nuk mund të rri rehat." Pastaj, rreth orës 15 po dëgjohej turma e protestuesve, e ne ua ndalonim nxënësve që të dilnin në këtë kohë. Mustafa desh të dilte. Në fillim e ndalova, po pastaj, pas insistimeve të tij që të dilte, dolëm së bashku. Kur e pamë turmën e madhe të protestuesve, i thashë Mustafës: "Duhet të shkojmë përsëri në Medrese, për t'i organizuar nxënësit. E, Mustafa më tha: "Hoxhë efendi, ruaju sa të mundesh, e unë po shkoj!" Dhe pastaj ka hyrë në turmën e protestuesve. Prej asaj që e kam dëgjuar, e kam mësuar se pas kacafytjeve të tij me policët, dhe pas djegies së autobindës së forcave serbe me naftë, një snajperist e kishte fokusuar prej kohësh, dhe e godet me plumb për ta vrarë. Më vonë e kemi kuptuar se Mustafa ka vdekur. Më kanë thirrur disa student që e kishin bartur Mustafën deri në një mishtore aty afër. Dhe, më kujtohet mirë fjala e një studenti për Mustafën: "Lum shpija, lum shkolla, e lum vendi që e ka pasur!" Ka qenë i vetmi protestues që është kacafytur me policët. Në fshatin e tij, në Reçan të Suharekës, e kanë varrosur, dhe nuk kanë lënë gati askënd që të merrte pjesë, përveç familjes. Në varrim nuk kam mundur të shkoj as unë, po në vizitë te familja po. Gjashtë punkte të policisë e kanë ruajtur fshatin Reçan, në mënyrë që të mos e lejonin askënd të merrte pjesë në varrimin e tij. Mustafa, falë Zotit në kohën kur është vrarë, e ka pasur gruan shtatzënë. Tani Mustafa e ka një djalë, e

i cili e ka marrë emrin e babait, pra Mustafë, dhe i cili i ka përfunduar studimet. Gëzohemi shumë se është djalë mjaft i suksesshëm. Pra, kjo ishte dashuria e tij për Medresenë. Ai që e do Medresenë, e do edhe fenë edhe vendin e tij.

Redaksia: Jemi të informuar se përvojës suaj në Me-

PO TË KISHTE MUNDËSI, DËSHIRA IME
DO TË ISHTE QË ÇDO I RI TË KALONTE
NËPËR DYERT E MEDRESESË, E PASTAJ
TË SHPËRNDAHESHIN NË ÇDO LËMI.

drese po i vjen fundi. Edhe pak kohë ka mbetur larg pensionimit tuaj. Pra, bashkë me ne po e përfundoni Medresenë edhe ju. Cilat janë porositë tuaja për brezin tonë, si dhe për brezat e ardhshëm që do të vijnë në Medrese?

Sulejman Osmani: Sipas meje, puna më e madhe që mund ta bëjë një i ri është që të jetë medresist. Duke filluar nga ato që dhuron Medreseja, si: dituria, morali, feja, e mbi të gjitha aftësitë për jetën. Medreseja është e shenjtë. Misioni i saj e bën të tillë. Dikur neve na dhimbsej medresisti, ndërsa tani ndihemi krenarë për të. Po të kishte mundësi, dëshira ime do të ishte që çdo i ri të kalonte nëpër dyert e Medresesë, e pastaj të shpërndaheshin në çdo lëmi. Nuk është misioni i Medresesë që t'i bëjë nxënësit vetëm imamë. Sot kemi medresistë të angazhuar në politikë, ekonomi, diplomaci etj. Kemi nxënës që ushtrojnë funksione të larta në shtet. Kemi edhe kryetar komune medresist, siç është rasti në komunën e Vushtrrisë, apo edhe deputet. Pra, porositë ime do të ishte që t'i përmbaheni gjithmonë mësimëve të kësaj shkolle. Dhe, dashtë Zoti, të keni gjithmonë suksese, shëndet e të mirat!

Redaksia: Ndoshta pak ju kemi emocionuar me pyetjet tona, për shkak se kur flitet për Mustafë Veselin, dhe për atë periudhë, normalisht se ka emocion të veçantë. Po, ju falënderojmë shumë për kohën që keni gjetur për ne! Ju urojmë pension të rehatshëm, dhe shëndet e gjithë të mirat!

Sulejman Osmani: Falemnderit juve që më keni nderuar! Këto janë edhe çastet e mia të fundit me këta maturantë, e të cilët po cilësohen si më të mirët. Zoti ju ruajttë, dhe paçi suksese gjithmonë!

*Intervistuan: Granit Sadiku 12/2
dhe Hatixhe Hasani 12/4*

Një realitet

Është thënë se fjalët e fundit janë ato më origjinale, ato që burojnë nga thellësia e shpirtit, oqeanit më të thellë të krijuar prej Zotit. Po, pse vallë duhet pritur momenti i fundit që gjithçka të jetë origjinale dhe e kulluar?! Apo për shkak se fundi është kapitulli në të cilin shkruan "s'ka kthim prapa"!

Kur fundi të troket në derë, të gjithë janë afër teje, mirëpo vetëm pak prej tyre janë me ty. Kur të shtrihesh për të dhënë frymën e fundit, të gjithë do të derdhnin lot, mirëpo, fatkeqësisht shumë prej tyre do të jenë lot gëzimi.

Secili që lexon apo dëgjon këta rreshta, pa dyshim do ta pyes vetën: "Vallë, këto që ky i ka shkruar ky, a janë të vërteta?" Për dikë edhe mund të jenë. E për dikë edhe mund të jetë humbje kohe ky lexim. Megjithatë, nuk është edhe aq e rëndësishme kjo pjesë. Është e rëndësishme që ti ta thuash atë që do, edhe nëse të gjithë ngrihen në këmbë.

E di pse?

Sepse edhe po të flasin e bërtasin kundër teje, s' do të jesh këtu për t'i dëgjuar.

E di se si është kjo botë?

Shumë njerëz dëshirojnë të marrin prej teje atë që ti e do më së shumti dhe je më meritori për të.

Po, pse vallë? Pse secili nuk e jeton jetën e tij duke u marrë me atë që i përket?

Mbase, në këtë jetë s' do të kesh rast dhe kohë ta mësosh. Mirë! pa e mësuar nuk do të mbetesh.

Mbase urrehesh aq shumë, saqë ata që të urrejnë mundohen të ta marrin edhe ajrin, dhe të të lënë të ngordhësh, se për të vdekur sot mes njerëzve as që bëhet fjalë.

E di se cili është ilaçi më i mirë për ata njerëz?

Lumturia jote. Suksesi yt! Njerëzit e tillë vuanjnë kur ti përparon. Kur e shohin në fytyrën tënde buzëqeshjen, dhe kur vërejnë se në zemrën tënde ka dashuri të pakufishme, madje edhe për ta.

Jeta është e shkurtër, prandaj jetoje atë siç do ti, dhe me ata që i do më së shumti. Para se të largohesh, falënderoji ata që s' ta lëshuan dorën asnjëherë, edhe kur ishe në humnerën më të thellë, mirëpo edhe ata për të cilët fryma jote ishte tufan, sepse falë tyre je këtu ku je! Mbaje mend, jeta është si një stilolaps! Shfrytëzoje atë për të shkruar vetëm gjëra të mira, dhe kur të të harxhohet, drita në fund të tunelit veçse do të jetë e ndezur për ty!

Mbaje mend se pak janë ata që, kur emri yt të mbetet në këtë botë, do të të kujtojnë. Do të jesh i harruar nga të harruarit. Përveç për ata që në zemrat e tyre patën dhembjen kur dëgjuan për ikjen tënde.

Do të doja të të rrëfej ende, mirëpo, më fal, se unë po iki! Lamtumirë!

Dren Lipaj 12/2



VLERA E BEGATIVE TË ALLAHUT

Vendosa një ditë t'i numëroja begatitë e Allahut, dhe e pashë se ato ishin të panumërueshme. Me të vërtetë, pasi vendosa t'i shikoj ato, fillova t'ua di vlerën. Zemra ime po bëhej edhe më e përulur ndaj Allahut xh.sh. E ndieja vetën se duhej të veproja diçka. Duhej të bëja diçka në shenjë falënderimi ndaj Tij për gjithë këto mirësi. Nuk isha rehat derisa e dëgjova fjalën medrese. M'u kujtua se falënderimi më i mirë që mund t'ia bëja Allahut ishte mësimi i fesë së Tij.

M'u kujtua fjala e atij, a.s., që është dhënë si porosi: "Kujt Allahu ia do të mirën, ia mundëson të kuptuarit e thellë të fesë së Tij". Vendi ideal për të mësuar fjalën e Allahut tashmë dihej.

Besoj se ne jemi të zgjedhurat e Allahut në këtë vend të zgjedhur. Jemi të bekuarat në vendin e bekuar.

Shpresoj që, siç jemi ne krenare me ty, Medrese, edhe ti të bëhesh krenare me ne!

Amira Dërguti 10/4



O NXËNËS I DIJES!

Përgëzime për këtë rrugëtim. Dije se Allahu të fal ty dhe mua, si shumë njerëz të nderuar në shoqëri kanë kaluar në të njëjtën rrugë, ashtu sikurse dhe ti e unë! Qëllimi i këtij rrugëtimi duhet të jetë kënaqësia e Allahut të Lartësuar, tek i Cili nuk humbet asgjë prej mundit dhe lodhjes, vështirësisë dhe pengesave të shumta, e për të cilat njeriu brengoset dhe harron se shpërblehet prej Tij qoftë edhe në këtë dynja.

Ki kujdes! Mos të të bëhet qëllim i këtij rrugëtimi një letër e lustruar, e që ndoshta të hyn në punë në këtë dynja, e ndoshta jo, dhe për të cilën përpiqesh me të gjitha mënyrat për ta pasur në duar! Në këtë rrugë do të hasësh shumë pengesa, qoftë nga vetvetja, apo edhe nga rrethi ku jeton, po ti mos i bëj këto pengesa arsyetim për kryerjen e veprimëve të ulëta, e të luaj shejtani me ty duke të pëshpëritur në vesh se, ja, nuk ka problem, se, ja, ti ke shumë pengesa, e kështu me radhë.

Ki frikë Allahun, kudo që të jesh, se njerëzit ndoshta të shohin, e ndoshta nuk të shohin, po Allahu është Ai që të sheh, si në vetmi, e si me njerëz! Nëse do Ai, veprimet e ulëta që bëhen në vetmi të dalin në shesh, e nëse do, t'i mbulon. Mbështetu te Zoti yt në të gjitha vështirësitë, dhe bëji të gjitha sepepet, e do të jesh i nderuar para Allahut dhe para njerëzve!

Festina Brahimi 12/3





ISHTE E BUKUR, EDHE PSE...

Ishite e bukur edhe pse në sytë e saj rridhnin lot pa ndalur. Jeta i solli shumë pakënaqësi, e megjithatë ajo jetonte me shpresën se nesër do bëhet mirë.

Nganjëherë ndihej shumë e vetmuar. Jetonte vetëm, ajo dhe vetmia e saj. Nganjëherë ndihej shumë e shoqëruar, kuptohet, me lotët, dhembjen, si dhe çdo gjë që e bënte të kishte një jetë pa kuptim.

Kur nata vinte, dëgjohej duke shtrënguar kokën për jastëkun e saj, duke u ngulfatur që askush të mos ia dëgjonte të qarat. Fshihej nga trishtimi që të mos e merrte vesh nëna. Fytyrën e trishtuar të nesërmen e mbulonte me fytyrën engjëjllore. Edhe pse ishte shumë e vetmuar, ajo prapë ishte shumë e fortë.

Jeta nuk i solli të mira. E sprovoi me shumë sfida, e prapë se prapë ajo u ngrit në këmbë çdo ditë, duke thënë se nesër do të fillojnë ditë të mira.

Firdevse Gashi 12/3

DASHURIA E SAJ

Mendova që mund të kaloja jetën edhe pa të. Mendova që isha forcuar mjaftueshëm që të kaloja jetën pa dashurinë e saj, e cila është vetë jeta. Ndoshta, sa isha afër ngrohtësisë së saj, nuk ia dija vlerën. Nuk thonë kot se një personi nuk ia di vlerën derisa e humbet, apo derisa nuk e ke afër. E doja, dhe e dua shumë. Si të mos e dua, kur ajo është personi më i rëndësishëm i jetës sime?! Është shtylla kryesore që, po të rrënohet, do të rrënohej gjithë çfarë kisha ndërtuar deri më sot.

Mirëpo, unë vetëm u sprovova.

U largova prej saj. Edhe e kuptova. Çdo sekondë që kalonte e unë isha larg saj, më dukej se po kalonte një jetë. Më mungonte ngrohtësia dhe dashuria e saj, dhe mezi prisja të isha pranë saj përsëri.

Dhe, më në fund erdhi dita që ta shihja përsëri. Dhe filloi përsëri ajo ndjenja e çasteve sa tërë jeta. Rrugë më dukej e largët deri sa të arrija te ajo. Më dukej sikur kisha ngecur në një rrethrotullim, dhe nuk po e ecja fare drejt saj. Disi arrita të jem para derës së saj. U afrova afër saj, dhe fillova të qaj ashtu sikurse qante edhe ajo. E përqafova, sikurse edhe ajo mua, dhe e putha në ballë. Sepse aty puthen mbretëreshat. Ia putha sytë, ata sy që më shikuan edhe kur të tjerët u larguan prej meje, dhe zemra përsëri m'u mbush me jetë: me dashurinë e saj. Me dashurinë e asaj që askush nuk mund t'ia zërrë vendin. Me dashurinë e nënës.

Venhar Bilalli 12/2



MOS U DORËZO

Në jetë ne përballemi me sfida të shumta. Më mirë të themi se e tërë jeta është një sfidë. Problemet s'kanë të ndalur. Vuajtjet, vështirësitë që duhet kaluar... E gjithë kjo shkakton një pikëllim të thellë. Secili problem ndryshe nga tjetri. Secili më i vështirë për ta përballuar. Secila vuajtje lëndon zemrën më shumë sesa tjetra. E pas një kohe të gjatë, kur kalon një periudhë dhe në jetën tonë nuk ndodh asgjë përveç problemeve dhe vështirësive, ne vijmë deri te dorëzimi. Një tjetër gabim i madh!

Përkundrazi, ne duhet të luftojmë, që ta kuptojmë se secila nga vështirësitë na mëson diçka të re, dhe na përgatit edhe për sfida më të vështira. Thjesht duhet kuptuar se, nëse dorëzohemi, vështirësitë e jetës nuk do të lehtësohen, mirëpo do të bëhen më të vështira.

Merita Qazimi 11/4



JETA

Ah! Ishe e gjithë bota për mua. Ishe arsyeja kryesore që unë hapja ditën të vazhdoja tutje. Madje edhe sot, vetëm kujtimi për ty më mban gjallë. A thua vallë, pse jeta bëhet kaq e hidhur ndonjëherë?! Sikur të mund ta ktheja kohën, do të kisha dhënë gjithçka. Edhe pse dëshira dhe vullneti i Zotit deshi që ti të mos jetosh më me mua, megjithëse unë prapë do të vazhdoj të jetoj me ty.

“Nëse nuk e çmon jetën, atëherë ti nuk e meriton atë.”

Enesa Avdiu 10/4

Një fëmijë dhe një
laps ndryshojnë
botën!

Gjersa të gjithë shokët e tij vraponin të merrnin telekomandën, apo lodrën e preferuar, ai ulej nën dritën e llambës vezuluese, merrte një letër dhe lapsin e tij të preferuar, që nga mprehjet e shpeshta kishte arritur të dukej i gjatë sa gishti tregues, mirëpo prapë shkruante, dhe duke menduar se ishte lapsi ai që e krijonte një botë aq të bukur, ai i jepte gjuhë mendimeve dhe përjetimeve të veta, dhe kështu i dukej sikur po ndryshonte diçka. Vetën. Edhe Botën.

Nganjëherë frikësohej ta pranonte se ishte mendja e tij ajo që thurte aq bukur. Frikësohej të mendonte se ndoshta ato mendime do të botoheshin e lexoheshin nga njerëzit, apo ndoshta dikush do të krijonte kohë për të!

Po fillove ta lexosh, sikur të ishte bërë me mjalhtë,
të kapej në duar! Aq shumë rridhnin mendimet, sa
dukej që letra e tëra ishte me vaj, e lapsi rrëshqiste
në të duke krijuar vargje lulesh!

Dikur edhe shpresonte që shkrimin e tij ta shite në raftet e bibliotekave, duke qëndruar afër librave të Lasgushit e Naimit, edhe pse e dinte se prapë nuk do të ishte si një nga perlat e tyre. Megjithatë, i mjaftonte që me botën e tij të ishte pranë tyre. Me botën që e kishte ndryshuar ai.

Ermira Rrahimi 12/4

SOT

Po jetojmë në një kohë aq të pakuptimtë, në një shoqëri aq të palogjikshme, sa sot pakush di të thotë se çfarë kohe është kjo. Jetojmë në një kohë kur fajtori lavdërohet, e i pafajshmi fajësohet dhe dënohet! I pasuri pasurohet, e i varfri edhe më tej varfërohet! Në një ambient ku, të jesh e mbuluar, është më mëkat sesa të jesh e zhveshur! Ku e moralshmja poshtërohet, dhe e pasjellshmja nderohet! Të shpifurat nuk ndalen: shpifin për të pastrit, për të moralshmit, e ndyrësitat nderohen me lavde e nam.

Ka kohë të gjatë që merremi me njerëz me kokë të koklavitur, dhe torturojmë logjikën tonë. E ne, duke qenë të pafuqishëm, biem në tokë dhe kërkojmë forcë vetëm tek Ai që është vërtet i Fuqishmi, te më i Larti.

Dhe lutemi: O Zoti ynë, mbrona nga mëkatet e kësaj bote, na i forco zemrat tona, dhe na jep çelësin e kalimit të gjithë kësaj dhimbjeje, ashtu siç ua dhe shumë besimtarëve para nesh! Na jep durimin, o Zot! / *Abide Gërbeshi 11/4*



JETA I NGJAN TRËNDAFILIT

Jeta është aq e bukur, sa të ngjan me trëndafilin. Po, me të vërtetë i ngjan trëndafilin, sepse nëse ti dëshiron ta marrësh atë afër vetes, së pari duhet të ballafaqohesh me gjembat e tij. E njëjtë është edhe me jetën! Po të duash të marrësh gjërat e bukura të kësaj jete, duhet të përgatitesh të ballafaqohesh me gjembat e saj, e pastaj të arrish tek e bukura.

Bleona Krasniqi 12/3


ADOLESHENCA

Është një periudhë e jetës gjatë të cilës çdo njeri, ishte, është, apo do të jetë i prekur nga pasojat e saj. Adoleshenca. Flas këtu për kohën kur njeriu mendon se ka marrë krahët dhe mund të fluturojë në qiellin e pafund, atje ku askush përveç tij nuk arrin dot.

Në fakt, realiteti është krejt ndryshe. Ne jemi thjesht si shembulli i një anijeje, e cila gjendet diku në Oqeanin Paqësor, dhe që synon Gjirin e Panamasë, e të vazhdojë më tutje.

Prindërit, profesorët, e të rriturit e tjerë, të cilët e kanë pasur këtë rrugëtim më parë, janë ata që na mësojnë të përdorim busullën dhe të orientohejmë sa më drejt. Dhe japim maksimumin në këtë drejtim. Mirëpo, ne në këtë periudhë, të karakterizuar me kriza personale, emocionale e morale, nuk ua vëmë fare veshin. I konsiderojmë piratë të anijes sonë. I llogarisim si piratë që kanë vetëm interes prej nesh, dhe nuk shikojnë gjë tjetër përveçse rrugës e cila iu konvenon atyre.

E vërteta është se ne kemi hapur velat dhe i kemi drejtuar ato andej nga fryn era më e fortë. Dhe, fatkeqësisht, tani në kohën tonë, kur nevoja jonë për këshilla është më e madhe se universi, në këtë kohë uraganet po na sulmojnë në të katër anët. Prandaj, kujdes nga "uraganet"! Ata përpiqen që ta devijojnë rrugën tonë. / *Ardit Krasniqi*



MENDOJ SE ASGJË NUK ËSHTË E PAMUNDUR

Mendoj se asgjë nuk është e pamundur. Shpresa dhe mendimi i mirë të orientojnë nga e drejta, nga ajo tek e cila ti do ta gesh lumturinë, tek ajo e cila do ta mësosh se si është ndjesia e të qenit i lirë.

Si është të flasësh e të të dëgjojnë, të të përkrahin dhe të të respektojnë?! Kjo është ajo për të cilën të gjithë kanë nevojë.

Mirësi dhe pak buzëqeshje që dikujt t'i dhurosh, pak shpresë për jetë, kjo është e gjitha që dikush mund ta ketë nevojë. Dhe, është falas. Nuk të kushton asgjë më shumë se qetësi në shpirt. Mendo mirë, dhe kujdes se ç'flet! Guri që hodhe sot, mund të jetë ai tek i cili do pengohesh nesër.

Medina Gashi 11/3

NUK ËSHTË FUNDI

Fundi yt nuk është fundi i botës, ngase asgjë nuk ka filluar me ty. Ditëlindja jote ka qenë dita kur dikujt ia shkrua në mermer epitafi! Koha kur the fjalën tënde të parë ishte kur dikush tha fjalën e fundit! Kur ti qesh, nuk qesh e gjithë bota. Dikush afër, apo larg, përjeton dhembje! Dita më e lumtur e jetës tënde mund të jetë ditë mërzie për dikë! Prandaj, edhe kur bota kthehet mbrapsht për ty, kujto se ke për kë të buzëqeshësh! Ky nuk është fundi. Është vetëm koha jote. /Fortesa Avdiu 10/5

DHEMBJE QË BASHKON

Kur zemra të thyhet copë-copë, çdo gjë të duket e thyer. Të duket sikur bebëzat e syve tu janë ndarë në miliona copëza të vogla, dhe sikur vetë jeta është ndarë në të tilla copëza. Zemër e bashkuar, të duket histori e largët. Në ca momente edhe fjalë e panjohur për ty. Sikur tërë jetën të kishte qenë e tillë.

Në njërin anë tënden është buzëqeshja jote, e edhe kjo të ngjan e thyer gjithashtu. E humbur..., aq shumë e humbur. Po, kjo është shprehja e duhur për ty.

Kaluan ditë, kaluan net, e sikur bota u bë bashkë. Sikur copëzat në bebëzën tënde u zhdukën. Sikur buzëqeshja jote nuk ishte më e thyer! Në krahët e diellit e gjen veten të lumtur, e Hëna, dikur e ndarë, tani të ngjan se është e plotë. Kjo pamje ta mbush zemrën, sa e kupton se as ajo nuk qenka e thyer më! Dhe habitesh me veten se si ndodhi kjo. Thellohesh në oqeanin e dikurshëm të kujtimeve, dhe e kupton se ishte vetëm dhembja ajo që të theu. Dhe e kupton se është po dhembja e njëjtë ajo që të paska bashkuar!

Hatixhe Hasani 12/4



RRUGA QË KAM ZGJEDHUR

Për të arritur një rrugë të mirë është më se e vështirë, ose, siç thotë populli: “Rruga e hajrit i ka hjekat e saj”. Kur vendosa që të marrë rrugën drejt një shkolle të mirë dhe të suksesshme, mendoja për parimet e saj. Një shkollë që ngërthen në vete sjelljen, edukatën dhe moralin. Si çdo e re, edhe unë kam ambiciet e mia, që të vazhdoj tutje me hapat e mi të brishtë. Mirëpo, kam mësuar që ndërtesa më e fortë është ajo që është stoike në themelin e saj. Shpresoj që një ditë do të jemi pikërisht ato të fortat e stoiket që burimin e kanë të atillë siç e ka shkolla jonë. /Ndrina Zhushi 10/4



SIKUR VETËM EDHE NJË HERË...

Atëherë kur zemra për ty ndien mall, loti do të jetë më i rëndë se qielli. Mos kalo! Sepse vetëm pak kam për të thënë... , sepse vetëm pak na ka mbetur. Ndoshta po e pret fundin e rreshtave, sikur unë kur prisja që ditët të fluturojnë! Të mban gjallë dritë e diellit, mirëpo prapë e pret natën t’i numërosh yjet. Sepse ata dinë sekretet tua. Shpejt apo ngadalë, nuk besoj se tani ka rëndësi. Sepse askush një shtator tjetër s’po na e falë. Vetëm edhe një herë të kthehesha, e dritës dhe bereqetit tënd dakikun nuk do t’ia kisha falur. Se të kalosh nëpër dyert tua është si t’i hapësh drynat e dyerve të Tokës dhe Qiellit. Fllad i qershorit do të mbyll dritaren tonë, për t’ua hapur derën të tjerëve në shtator. Nuk perëndoi dielli. Nuk do të lindë prapë. Tani po ia jep qiellit ngjyrat më të bukura që ka pasur ndonjëherë! Do të më kuptosh kur zemra jote të ndiejë mall, dhe loti për Medresenë të të jetë më i rëndë se çdo lot tjetër. Sikur vetëm edhe njëherë..., në bankat e tua...

Ëmbëlinë Sahiti 12/4

E DASHUR MEDRESE

Po të shkruaj letër duke qenë nxënëse e jotja edhe për pak ditë. Nuk di nga t’ia filloj që të shkruaj për atë që përjetova në ty. Zemra dridhet, e pas saj edhe dora. E, tani shkrimi sikur filon të më fusë brenda tij, e të më thotë se kam shumë për të shkruar!

Thonë që ndjenjat është lehtë t’i derdhësh në letër, por gjë më të vështirë nuk paskam përjetuar. Para se të bëhesha nxënëse e jotja, i numëroja ditët plot gëzim, e tani që do largohem nga ti, po i numëroj ditët plot lot! Ende i kujtoj momentet e para në ty: e heshtur dhe duke pritur çfarë do të ndodhë më pas; si do të jetë jeta në ty; si do të frymoj në ty... Teksa i kujtoj këto momente, e kuptoj se sa me fat paskam qenë! Më kujtohet çdo gjë, sikur të ishte duke ndodhur prapë tani.

Përjetova shumë vështirësi në ty, shumë lot hidhërimi, dhimbjeje e dëshpërimi, mirëpo ti më mësove si t’i ktheja ata lot në gëzim, se si ta ktheja në buzëqeshje fytyrën plot brenga, se si... Epo, ti më mësove aq shumë.

Ti je ndryshe. Ti me të vërtetë je ndryshe. Dhe çdo gjë në ty përjetohet ndryshe! Ti më dhe shumë. Tek ti mora dituri dhe gjërat më të mira. Ti më afrove drejt Atij që e caktoi të jem nxënëse e jotja. Tek ti takova personat që asnjëherë nuk ma mori mendja që do të jenë familja ime e dytë. Tek ti kuptova se çfarë do të thotë fjala shoqëri. E, mbi të gjitha, tek ti kuptova se kush jam unë.

Pas tre vjet udhëtimi të përbashkët, erdhi koha që unë të eci e vetme. Shumë shpejt erdhi koha të largohem nga ti, për të mos u kthyer kurrë më si nxënëse në bankat tua!

Të falënderohem për çdo gjë që më ke dhënë! Për çdo çast të bukur që ma fale! Për kohën që kalova në ty! Do të mbesin gjithmonë pjesa më e bukur e kujtimeve të mija. Do të kujtoj çdo gjë tënden dhe, në të vërtetë, do të më mungojë shumë çdo gjë e jotja.

Hatixhe Hasani 12/4



Photo by: Fikion Zharku

DO TA ARRISH QETËSINË

Do të arrish të jesh i qetë vetëm atëherë kur fjalët e të tjerëve të mos kenë ndikim në ty. Të mos kesh luhatje humori vetëm prej një ose disa personave.

Kur të kesh krijuar personalitetin tënd, dhe ta dish se çfarë do me të vërtetë.

Të luftosh për atë që do, dhe këtë ta bësh me mish e me shpirt, derisa ta kesh.

Humbjen s' duhet ta shohësh asnjëherë si opSION të mundshëm.

Do të jesh i qetë me vetën vetëm atëherë kur të mos kesh frikë të humbasësh njerëz, apo ëndrra.

Gjithmonë mendo pozitivisht, dhe mos lejo asgjë dhe askënd të bëhet shkak për dhembjet e njëpasnjëshme që të çojnë në humbje!

Sara Islami 12/3



MBI NXËNËSIT

Unë quhem Fatbardha Islami. Jam nxënëse e shkollës së mesme "Medreseja e Mesme Alauddin", në Prishtinë. Jam në klasën e 11-të, paralelja 4. Që nga viti 2011 merrem me sportin e karatesë. Sporti i karatesë synon të ndërtojë karakter, të përmirësojë sjelljen njerëzore dhe të kultivojë modestinë. Për tetë vjet sa jam duke u marrë me këtë sport luftarak, kam marrë shumë çmime: më shumë se 10 herë jam zgjedhur Kampione e Republikës së Kosovës, mbi 6 herë kampione e mbarëkombëtare dhe, në vitin 2014, e mora vendin e 3-të në WSKU (World Shotokan Karate Union). Po ashtu, jam edhe gjysmëmjeshtre e Karatesë, dhe pritet që në të ardhmen ta marr titullin "Mjeshtre e Karatesë" (1 Dan).

Unë jam Elmedina Berisha, nxënëse në "Medresenë e Mesme Alauddin", në klasën e 11-të, paralelja 3. Përveç mësimave që vijoj, jashtë orarit mësimor shfrytëzoj kohën edhe me aktivitete të lira. Tash e tri vjet jam edhe sportiste në artin luftarak Taekvondo. Taekvondo është një art luftarak korean, i ngjashëm me karatenë, mirëpo më shumë veçohet në teknikat (goditjet) me këmbë. Këmbea është më e fuqishme, dhe ka një shtrirje më të gjatë se krahu (dora). Taekvondo do të thotë "Arti i dorës (grushtit) dhe këmbës". Si sport ka dobi të shumta: vetëmbrojtje, përqendrim, rritje e vetëbesimit etj. Disa nga garat ku kam marrë pjesë janë:

"Tirana Challenge": Vendi i 2-të;

"Tirana Trophy": Vendi i 1-rë;

"Kampionati i Kosovës": Vendi i 1-rë, dhe;

"Top Tirana Open 2019": Vendi i 3-të.

Këto gara nuk do të jenë të fundit, sepse kam për qëllim të arrij edhe në të ardhmen ta përfaqësoj vendin tim dhe fenë time, në mënyrë që t'u tregoj edhe të tjerëve se feja ime nuk ma ndalon të ndjek pasionin tim, përkundrazi është motivim të vazhdoj përpara.

"Suksesi nuk vjen te ti për të të gjetur, por ti duhet ta gjesht atë."

“WAKE UP AND LISTEN TO YOURSELF”

My name is Sara Islami. I'd like to begin by talking about myself. I was born in Gjakova. It's a really beautiful place. I spent a very happy childhood there and I was just an ordinary girl. I used to look up in the night sky in wonder and I used to dream the dreams of a girl. I used to imagine that I was a superhero who could save the world and I heard a line that says "My heart stopped when I was maybe nine or ten". And I really felt that. Looking back I think that's when I began to worry about what other people thought of me and started seeing myself through their eyes. I stopped looking up at the night skies the stars. I stopped daydreaming. Instead, I just tried to jam myself into the moulds that other people made. Soon I began to shut my own voice and started to listen to the voice of others. No one called my name neither did I. My heart stopped and my eyes closed shut. So, like this I, we all lost our names. We became like ghosts. But I had one sanctuary and that was conscience. There was a small voice who called my name. "Wake up and listen to yourself". But it took me a quite long time to hear conscience calling my real name. Even after making the decision to join Medressah there were a lot of hurdles. Some people may not believe it but most people thought I was hopeless. And sometimes I just wanted to quit. But I think I was very lucky that I didn't give it all up. And I'm sure that I and we will keep stumbling and falling like this. If there's anything that I achieved It was only possible I have my other part Family right by my side. And maybe I made a mistake yesterday but yesterday's it's still me. Today I am who I am with all my faults and my mistakes. Tomorrow I might be a tiny bit wiser and that would be me too. These faults and mistakes are what I am making up the brightest star in the constellation of my life. I have come to love myself for who I am, for who I was and for who I hope to become. I'd like to say one last thing. Let's take all one more step. We have learn to love ourselves so now I urge you to "speak yourself". I'd like to ask all of you... What's your name? What excites you and make your heart beat? Tell me your story. I want to hear your voice and I want to hear your conviction. No matter who you are where you're from your skin color your gender identity just speak yourself. Find your name and find your voice by speaking yourself. Like many people I've made many and plenty mistakes in my life. I have many faults and many more fears but I'm gonna to embrace myself as heard as I can and I'm starting to love myself, gradually, just little by little What is your name... Speak yourself! / Sara Islami 12/3



LIFE HAPPINESS

I'm not okay. How can I ever be okay? I'm living the life, I really love it. I feel love, joy, happiness. I'm really so happy. God brought me here, to a family who loves me, friends who care about me, and my God who protects me from above.

I really don't know what made me this way. I laugh for no reason, I smile for nothing, I'm always happy, I don't wanna change the way that I feel; about this world. I know it's hard, sometimes it's very challenging and almost depressing living in this world.

But why should we be sad?! Live gives us only a chance, why waste it in sadness, pain, depressing. I know that isn't our choice and some people are more emotional than others, but we should help each-other and live this life happy. There are tons of things to be happy about. Be happy that you have a mover who loves you, a sister who gets on your nerves, a friend who is always there for you, are the little things that really matter. Be thankful that you have a heart that does all that work so you can live and enjoy it. There are so hard times for some people, even for us, but we need to keep moving forward and show something to this life. I wanna tell you something. Listen! Look inside yourself find that crazy giant beast you call life. Look it in the eye and with a deep breath, a proud heart and a strong mind say this: "You may be stronger than me, you may put me down thousand times, but I promise with all my heart, I will never back down. I won't lose my motivation everytime you will put me down. I will rise even stronger than before, I always will rise, until you will be afraid of me, until I will prove you I'm strong enough, until I will be the one that puts you down. That's my promise, I will do everything to beat you, just wait and see me rise.

Vjosa Ramadani 11/4

YOKSUN BURDA

Kayboldum kelimelerin arasında Kayboldum seni ararken aklımda Kayboldum bir tünelde Sen yoksun orda Ben yokum burda Ne dinlesem , ne görsem Seni hatlıyorum Ama biliyorum Sen dönmeyeceksin bir daha Kendimi soruyorum Neden sen gittin diye Ama cevap bulamıyorum Çünkü Allah böyle istedi Her gün ağalıyorum ama Bayramlarda fazlasıyla Erken kalktığımda babamı camiye uğurladığımda Seni uğurlayamıyorum dede Bayramdan döndüklerinde Hep eksik bir el oluyor öpmek için Hep senin elini öpemiyorum dede Mezun olduğumda sen orda olmicaksın Beni kutlayamicaksın İstemeye geldiklerinde senden istemek vardı Ama sen burda değilsin ve olmicaksın bir daha Biliyorum babam var , annem var Ama hiç biri senin yokluğunu dolduramıyor dede. Beyaz gelinliğimi giydiğimde Bir burukluk olucak içimde Sen yoksun ya orda Her şey kötü görünüşcek gözümde Bayağa oldu bu hayattan ayrılalı dede Bayağa !Bayağa oldu senin o temiz yüzünü görmeyeli 5 yıl. Koca 5 sene eksik yaşıyorum bu hayatı Keşke burda olsaydın ve birlikte türkçe konuşsaydık Keşke burda olsaydın birlikte çalışırdık her derste Özlüyorum senin için Özlüyorum fazlasıyla Bir kes daha seni görüceğime dair Ümidiyle yaşıyorum bu hayatı Belki kelimeleri iyi bağlamadım Ama türkçe'de yazmak istedim Sana bu sefer Beni dinleseydin gurur duyardın benimle Belki ağalardın da Ama işte yoksun burda Allah seni yanına aldı Benden götürdü seni Ama bir gün kavuşturacak Bize Allah En yüksek Cennete İnşallah Bu şiiri dedeme ağarman ediyorum.

Yazar: Rezana Lushta 11/3, Tarih: 30.09.2018, Yer: Mitroviça



A TË KAM FOLUR NDONJËHERË PËR MEDRESENË?!

Atë kam folur ndonjëherë për Medresenë?! Shkollën e kujtimeve të mia. A të kam tre-guar për dashurinë e madhe që kam për të?! Unë nuk di mirë të flas kur flas për gjërat që dua. As nuk di të shkruaj si e sa duhet kur shkruaj për to. Dashuria dhe përkushtimi im për Medresenë nuk mund të përshkruhet. Nuk mund as të interpretohet. Fotografitë tregojnë atë që shohin të tjerët, një shkollë madhështore. Mirëpo, ju betohem, askush nuk e sheh Medresenë si unë. Askush nuk i di ndjenjat e fshehtat që mban shpirti im për Medresenë, njësoj si-kurse Medreseja më mban mua.

A të kam folur ndonjëherë për Medresenë?! Ajo mua më përket. Është e brishtë në ngjyrat e veta, e qeshur atëherë kur shiu puth erën.

Ah sikur ta dëgjoni zërin e Medresesë! Ndoshta atëherë do të më kuptoni! Po, kush i kupton të mar-rët si unë, që dashurohen në mure, banka e karrige?! Në shkolla?! Në fakt, kështu e shohin njerëzit. Një shkollë, thonë ata.

Ah sikur t'i dinin të fshehtat që mban Medreseja! Sikur ta dinin që Medreseja ime buzëqesh, kërcen, këndon, fle, e mbi të gjitha frymon. Ajo është te secili prej atyre që ishin aty. Qoftë edhe për një natë.

A të kam folur ndonjëherë për Medresenë?! Për shkollën e mureve që ndan një botë?! Medreseja bashkoi edhe shpirtin e humbur për dijen dhe jetën, si ky imi.

Ah sikur të mund të flisja sa dua për Medresenë! Mirëpo nuk di. Ajo është lumturia ime dhe ngazëlli-mi njerëzor, buzëqeshja ime e parfumuar, fytyra ime.

Do të vijë një ditë tek ti, dhe do të jetoj përgjith-monë aty. Se ti je imja. Dhe, e di se askush nuk të njeh si unë. /Mirvete Karaliti 12/3

VITET NË MEDRESE

Të kërkoj leje për të hyrë në Medrese ishte gjëja më madhështore të cilën e kam bërë ndonjëherë. Mendoj kështu sepse ky vend ishte si një dorë e një njeriu të fortë e fisnik, e që po më tërheq nga një vrimë e errët dhe thellë në tokë për në sipërfaqe.

Jam shumë i lidhur me këtë vend, ngase këtu mësova se çka është jeta e vërtetë, dhe se çfarë është duke më pritur pasi ta lë mbrapa këtë vend. Dhe, kjo po që po më duket shumë e rëndë për ta bërë. Është fiks ajo ndjesia sikur e sheh veten se je në renë më të lartë, dhe je duke përjetuar kënaqësinë më të madhe që të është bërë dhuratë ndonjëherë, dhe sakaq të vjen kërcënimi se mund të biesh poshtë.

Filloj të thellohem në mendime, dhe arrij tek ajo koha kur bëra hapat e parë të këtu. Mendoj për të kohë kur gjeta shoqëri të pazëvendësueshme, e që tani më vjen ndërmend se jo edhe shumë kohë më ka mbetur me ta. Shoqëria e vërtetë të qëndron afër edhe pasi ta përfundosh misionin me ta. Kohën që e kemi shpenzuar këtu nuk do të jemi në gjendje ta kthejmë, e as ta përjetojmë më.

Qysh nga koha kur vjen këtu, nuk mund të ndalesh nga synimi e etja për punë. Çdo herë e më shumë ndihesh sikur me forcat e tua dhe dijen që merr këtu do të jesh në gjendje t'u ndihmosh njerëzve në çdo skaj të botës.

Prandaj, çdoherë kur dikush më pyet për këtë vend, përgjigjja ime do të jetë: vend më të mirë nuk ka, dhe vitet që kalova aty ishin vitet që asnjëherë nuk do të jem në gjendje t'i shijon më mirë.

Falënderimi i takon Zotit, që ma mundësoi të jem pjesëtar i një begatie kaq të madhe, sa falën-derimi i pandërprerë, ditë e natë, është i pakët! Po të vazhdoja ende të shkruaja për këtë vend, dhe po të kisha kohë sa meriton të shkruhet për të, do të më duheshin më shumë lapsa, ngase nuk mjaftojnë fjalët që kam shkruar për të treguar mirësinë e këtij vendi. Zoti mos e lëntë asnjë të ri pa këtë begati madhështore! /Valton Abdullahu 12/1



MEDRESEJA

Shkollat janë vatrat e dijes, si dhe vendet ku ne kalojmë një pjesë të ditës në bankat e tyre. Janë vendet ku ne miqësohemi me bashkëmoshatarë të tjerë. Aty marrim njohuri të reja. Medreseja ime është e veçantë: është ëndrra ime që kam pasur gjithmonë dhe tani m'u bë realitet; është vendi ku mësohet fjala e Zotit; ku përveç dijes mësohet edhe edukimi. Në Medrese ndihem vetvetja. Është shkolla ku dashuria për të është thellë në zemrën time. Është një ndjenjë e papërshkrueshme me fjalë, e që e ndiej thellë në qenien time.

Në këtë vend të bekuar gjeta miqësinë e bekuar, e që ndihem e lumtur në mesin e tyre. Ndihej me fat që jam pjesë e Medresesë.

Alberina Begaj 10/4

MEDRESISTE

Të gjithë kemi një vend ku e gjejmë veten, një vend ku e kemi një të kaluar që s'dëshirojmë ta harrojmë asnjëherë! Ne e ndërtuam veten këtu. Në fakt na ndihmoi ky vend ta ndërtojmë veten, të besojmë te vetja..., të besojmë se kur shpirti dëshiron diçka, e arrin atë në prani të njerëzve të duhur. Arritëm atë që deshëm. Arritëm paqen, shpirtin, frymën dhe atë lumturinë që, siç duket, do të na përcjellë tërë jetën. Dua t'ju falënderojë të gjithëve, një nga një. Faleminderit që na ndihmuat të jemi këto që jemi!


Fjalët e para të adhurimit ndaj Allahut ne i mësuam këtu. Të jemi afër Tij e mësuam këtu. Çfarë duam ne më tepër se kjo?! Në fakt, ata që të duan, të afrojnë tek Allahu. Ju e bëtë këtë. Ia arritët! Këtu, jo vetëm që gjetëm si të arrijmë kënaqësinë e botës tjetër, por gjetëm edhe si të arrijmë kënaqësinë e kësaj bote. Medreseja nuk është vetëm një shkollë. Është shtëpia e shpirtit. Është një familje e madhe. Një familje që nuk do të shuhet asnjëherë!

Unë e di që fjalët janë të pakta për të shprehur falënderimin ndaj teje, o Medrese, si dhe ndaj jush që na mësuat, për punën që keni bërë me ne, dhe që po vazhdoni ta bëni edhe me gjeneratat e tjera, po vërtet, zemrat dhe shpirtat tanë ju falënderojnë nga thellësia e tyre!

Ti në mënyrën më të mirë arrite t'i shëroje ato zemra, o Medrese e dashur, duke i mbushur me besim, dashuri e ngrohtësi.

Falënderimi i takon Allahut, që më bëri të jem pjesë e kësaj familjeje të madhe, dhe ta bart emrin Medresiste!

Artina Behrami 12/4



RRUGA QË KAM ZGJEDHUR


Për të arritur një rrugë të mirë është më se e vështirë, ose, siç thotë populli, "Rruga e hairit i ka hjekat e saj."

Kur vendosa që të vij drejt një shkolle të mesme, mendova ta zgjedh një të mirë dhe të suksesshme, një shkollë që ngërthen në vete mësimin dhe edukimin.

Si çdo e re, edhe unë kam ambiciet e mia, që të vazhdoj tutje me hapat e mi të brishtë, mirëpo edhe kam mësuar që ndërtesa më e fortë është ajo që është stoike në themelin e saj.

Shpresoj që një ditë do të jemi pikërisht ato të fortat e stoiket, me një burim nga kjo shkollë!

Ndrina Zhushi 10/4



SEKRETET E FUNDIT

Thonë se fundi çdoherë na e tregon mrekullinë e fillimit. Se në të gjendet sekreti i çdo gjëje.

Mirëpo, e dini çfarë? Nuk është vetëm aty. Çdo fund i ka sekretet e veta. Pra, mendoj se sekreti gjendet edhe diku tjetër. Shiko! Këtu, brenda zemrës sime.

Këtë vend që shndrit mbi errësirën që pret pushtim. Kjo mund të duket vetëm një ndërtesë, mirëpo nuk është thjesht një ndërtesë.

Desha të shkruaj edhe më shumë, mirëpo ndjeva se diçka po zvarritej poshtë faqeve të mia. Të jenë vallë kujtimet e rrënjësura të rrugës së shtruar me kalldrëm, që të dielave e urreja, e të premtëve e dashuroja? Apo buzëqeshjet, dhe bisedat me shokët?

Apo dituria, këshillat, dhe fjalët e profesorëve dhe edukatorëve?

Apo netët e shpenzuara duke e kujtuar shtëpinë time, pa e ditur se në të gjendesha?

Apo ditët e kujtuara me shoqërinë, pa e kup-tuar se shokët i kisha pranë?

Apo mëshira e Zotit, që më shoqëronte në çdo hap, dhe në çdo fjalë?

Të jetë vallë lumturia e grumbulluar gjatë kë-tyre viteve, e të cilën e kërkoj aq shumë?

Të jetë vallë kjo foleja e shpirtit tim?

Të jetë vallë kjo shtëpia ime? Vendi ku mësova jetën? Medreseja ime?

Miran Shehu 21/2

PSE ZGJODHA MEDRESENË?

Zgjodha Medresenë, sepse e dija që në të do të gjeja dituri, lumturi, ngrohtësi dhe shoqëri. Dhe se Medreseja është ajo dhe e vetmja e cila na i tregon hapat drejt suksesit. Dhe, besoj se e kapur për Medresenë time, edhe në të ardhmen do të arrij t'i prek edhe majat më të larta të suksesit!

Arlinda Behrami 10/5

Atëherë kur e sheh se ke ardhur në fundin e një rrugëtimi shkollor, e sheh se duhet të hapësh një derë të re. Me këtë rast unë u drejtova në Medrese. Zgjodha Medresenë, sepse është vatër diturie dhe dashurie. E vetmja shkollë që na mëson rrugën drejt lumturisë, Zotit. Zgjodha Medresenë, sepse është e vetmja shkollë që qetësoi zemrën time!

Hafsa Dërmaku 10/5



THËNIET E MATURANTËVE NGA KLASA 12/1

1. Abdusamed Bytyqi: "If you dont take risks, you cant create a future."

2. Adnan Kqiku: "Work, because being lazy is very expensive!"

3. Albesian Guri: "Krejt çka mund të ndryshosh është vetja jote. Mirëpo, nganjëherë ndryshimi i vetes mund të ndryshojë gjithçka."

4. Amar Rama: "Nuk ka njeri të dobët, por njeri që nuk i njeh forcat e veta."

5. Arian Bytyqi: "Nëse ti e përmirëson brendësinë tënde, Allahu do të ta përmirësojë të dukshmen."

6. Beshir Luma: "Stay original and let others copy you!"

7. Durim Luma: "Kur përballesh me vështirësi dhe e pyet vetën ku është Zoti, kujto se mësuesi qëndron i heshtur edhe kur ti ke provim!"

8. Elion Nuradini: "Unë nuk e di se çfarë mban e ardhmja ime, por e di se kush e mban atë."

9. Ensar Berisha: "Koha është gjëja më e vlefshme që një njeri mund ta shpenzojë."

10. Ermir Hasani: "Bëhu i fortë me vetën, se do të vijë dita që nuk do të kesh askënd përpos vetes tënde dhe Zotit!"

11. Eron Hajzeri: "Jetoje çdo ditë sikurse të ishte dita e fundit e jetës tënde!"

12. Fatbardh Hasani: "Ai që punon, do të shohë rezultate, ndërsa ai që fle, do të shohë ëndrra."

13. Fuad Bajramaliu: "Në Islam ujku i ndërrohet qimja dhe zanati."

14. Guxim Tërholli: "Vëllai yt është ai që të lajmëron për të metat tua, ndërsa shoku yt është ai që ta tërheq vërejtjen për mëkatet."

15. Ibrahim Hajdari: "Nganjëherë kemi nevojë të mungojmë, që të shohim se kush interesohet për ne."

16. Indrit Gashi: "Mund të ndryshosh atë çfarë bën, mirëpo s'mund ta ndryshosh atë që do."

17. Ismail Arifi: "Kallabllaku t'fshin."

18. Jasin Abazi: "Nëse një gjë në tërësi nuk mund të arrihet, nuk do të thotë që në tërësi duhet të lihet."

19. Mirlind Gashi: "Ta mësosh të gabuarën dhe të veprësh me të, është më e rrezikshme sesa injoranca."

20. Mumin Baftiu: "Nothing is impossible, but some people don't know how to make it possible."

21. Munir Sallahu: "Gënjeshtër më e madhe që ia them vetes çdo mëngjes është: edhe pesë minuta."

22. Petrit Sekiraga: "Perëndimet e diellit janë prova që përfundimet mund të jenë të mira po ashtu."

23. Qëndrim Sylja: "Liria shprehet në përmbajtje: kush është i lirë, është rob i vetvetes."

24. Shpetim Hasani: "Ia vlen ta duash vetveten, sepse është personi që të shoqëron tërë jetën."

25. Shuajb Ahmeti: "Duhet ta duroni dhimbjen, që ta shijoni fitoren!"

26. Usejd Ejupi: "Zogu asnjëherë nuk frikësohet se po thyhet dega në të cilën qëndron. Jo se i beson degës, por krahëve të tij."

27. Valton Abdullahu: "Buzëqesh edhe atëherë kur brendësinë tënde e kanë kapluar hidhërimet e jetës!"





THËNIET E MATURANTËVE NGA KLASA 12/2

1. Ajnor Bunjaku: "Faleminderit tërë atyre që më braktisën dhe më nënçmuan! Me "ndihmën" e tyre arrita kulmin e suksesit!"

2. Albin Berisha: "Mos u mundo të bësh gjithçka kur nuk je askush, por mundohu t'ia fillosh nga fillimi, e të bëhesh dikush!"

3. Albin Kurtishi: "Beso, dhe do të kesh sukses!"

4. Arbër Mustafa: "Kujtimet e brendshme vrasin. Ato të jashtmet trokasin."

5. Armend Kolica: "Edhe nëse vështirësitë të vërshojnë me vrull, prapë mos ndalo! Vazhdo përballjen me to, sepse përballja me vështirësitë të sjell suksesin e vërtetë!"

6. Besnik Berisha: "Nëse i tregon dikujt një sekret tëndin, ia ke dhuruar shigjetën me të cilën mund të të godasë një ditë."

7. Bali Qorraj: "Never give power to the big man! Sometimes you need to "unfollow" some people in the real time!"

8. Bekri Halili: "Kushdo që ka folur keq për mua ia kam bërë hallall! Nuk ia vlen që myslimani të ndëshkohet për shkakun tim!"

9. Denis Sylja: "Me humbje të betejës, gjeta shumë rrugë për të fituar."

10. Dion Hasani: "Jeta është e bukur, jetoje!"

11. Dren Lipaj: "Çdo fund i përmbushur shënon hapin e parë drejt një fillimi të suksesshëm."

12. Ermal Cej: "Çadra nuk e ndal shiun, por të ndihmon të kryesh punë gjatë shiut. E tillë është edhe shpresa, nuk të garanton në suksesin tënd, por të ndihmon në arritjen e tij."

13. Elif Krasniqi: "Kurrë mos mendo për ata që nuk mendojnë për ty!"

14. Fatlind Berisha: "Të luash role është e lehtë, të jesh vetvetja është e vështirë!"

15. Gentrit Osmani: "Një dorë e cila ta shtrëngon dorën kur të rrëzohesh është më e mirë sesa një mijë duar që ta shtrëngojnë dorën kur të ngrihesh."

16. Granit Arifaj: "Mos iu gëzo plagës së vëllait tënd! Vdekja e tij nuk e zgjat jetën tënde."

17. Granit Sadiku: "Në këtë jetë mendja është kontrata, trupi është vendbanimi, shëndeti është akomodimi, shpirti është vetë qiraja."

18. Leutrim Mehmeti: "Nothing is impossible. The word itself says "Im possible"."

19. Majlind Alshiqi: "I drejtë është vetëm Zoti, e ne të tjerët vetëm e luajmë rolin."

20. Miran Shehu: "Life is fair, because she's cruel with everyone! Let It go and live on!"

21. Rrezart Mustafa: "Buzëqeshja është një fjalë e bukur pa shkronja."

22. Ridvan Sekiraqa: "Njerëzve nuk iu intereson për ty nëse je i vetmuar, atyre iu intereson vetëm nëse janë të vetmuar."

23. Rijad Sogojeva: "Beso në Zot!"

24. Venhar Bilalli: "Buzëqesh, ngase kështu i vret ata që duan të ta shohin lotin tënd!"

25. Shaqir Selimi: "Nuk mund të jesh i vetmuar përderisa vlen për dikë."





THËNIET E MATURANTEVE NGA KLASA 12/3

1. Adelina Vllasa: "Le të jetë mendja pjesa më e bukur e trupit tuaj!"

2. Aida Koliqi: "Bëje të brendshmen dhe të jashtmen tënde një dritë që merr hapat drejt Xhenetit!"

3. Bleona Krasniqi: "Njeriu është sikurse gjethi, që në pranverë formohet, e në vjeshtë bie dhe zhduket."

4. Diella Kastrati: "Imagjinata është thjesht një univers mendimesh. Ja që edhe universi për ne është pjesë e imagjinatës."

5. Eljesa Hyseni: "Anijet nuk fundosen për shkak të ujit rreth tyre. Ato fundosen sepse uji futet brenda tyre. Mos lejo që gjërat që ndodhin rreth teje të hyjnë brenda dhe të të fundosin!"

6. Elona Dërmaku: "Mirësia është sikurse një qark i mbushur me energji pozitive, që në fillim përcillet tek të tjerët, dhe në fund kthehet sërish te vetja."

7. Ermira Gubetini: "Tigri dhe luani mund të jenë më të fuqishëm, mirëpo ujku nuk jep shfaqje në cirk."

8. Festina Brahimi: "Kulmi i durimit është të heshtësh ndërkohë që në zemrën tënde ka një plagë që flet. Kulmi i forcës është të buzëqeshësh ndërkohë që në syrin tënd ka një mijë lot."

9. Fideose Gashi: "Shpresa sheh të padukshmen, prek të paprekshmen dhe arrin të pamundurën."

10. Hyrije Sylja: "Bëhu si librat! Ato nuk ulërijnë, janë të heshtura, dhe në të njëjtën kohë thonë shumë gjëra."

11. Kaltrina Kosumi: "Mos merr vendim atëherë kur jeta të përplasë! Përplase ti atë, dhe thua jeta fjalën e fundit!"

12. Lejla Bahtiri: "Nga një e vërtetë e vetme të gjitha gënjeshttrat tunden. Qetësohu! Edhe mizat duan të krijojnë mjalhtë, mirëpo nuk munden."

13. Lejla Musli: "Njeriu mund të jetë gjithçka, mirëpo pa Zotin asgjë."

14. Lirie Ramliku: "Nëse ke diçka të bukur, mos kërko diçka më të bukur, e t'i humbësh që të dyja!"

15. Lirona Islami: "Gjëja më e frikshme është koha. Koha, çastet që i jetojmë, dhe që kurrë s'arrijmë t'i zotërojmë."

16. Marigona Pacolli: "Mundohu të lësh gjurmë të mira në udhëtimin tënd, dhe mos u bëj vetëm një kalimtar rasti!"

17. Mirjeta Llapashtica: "Nëse nuk mund të jesh një laps që shkruan lumturinë e dikujt, atëherë bëhu goma që fshin trishtimin!"

18. Mirvete Karaliti: "Marrëdhënia me të tjerët është si loja e rubikonit. Nëse e rregullon njëren anë, ana tjetër do të pësojë ndryshim. Prandaj, gjatë tërë kohës duhet të bësh kombinime e kombinime, në mënyrë që të arrish saktësinë ideale."

19. Qëndresë Kurtalani: "Mos harro se Allahu nuk e krijoi njeriun që të bëhet kundërshtar i Tij!"

20. Rejhane Zekolli: "Ndonjëherë e vetmja gjë që mund të bësh është t'i nënshtrohesh jetës dhe të lundrosh bashkë me valët e saj."

21. Sara Islami: "Ngjituni në maje për të parë botën, dhe jo për t'ju parë bota!"

22. Semire Hyseni: "Ditët do t'i bëj të mira, se ditë të mira nuk priten. Urrejtjet duan të na e vrasin, mirëpo në fund do të vetëvriten."

23. Suhejla Krustemi: "Ka vetëm një dallim mes ëndrës dhe qëllimit. Ëndrra kërkon gjumë të lehtë, kurse qëllimi kërkon përpjekje pa gjumë. Kështu që, fli për ëndrrën, dhe zgjohu për qëllimin!"

24. Sumeja Abazi: "Mos u bëj tokë, ku çdokush mund të pushojë, por bëhu qiell, ku çdokush dëshiron të arrijë!"

25. Sumeja Krasniqi: "Kindness is a key that can not be copied so careful dont lose it."

26. Shqipe Brahimi: "Nuk ka asgjë më të bukur sesa të qëndrosh për tri vjet me ju."

27. Valjeta Latifi: "Sikur shiu të ishte mjete me të cilin do të fshiheshin mëkatet tona, atëherë ai do të duhej të binte çdo ditë e çdo natë, pa pushim."

28. Xheneta Berisha: "Askush nuk është aq i pasur sa të mund të blejë të kaluarën e vet."





THËNIET E MATURANTEVE NGA KLASA 12/4

1. Ajshe Murati: "Në jetë janë tri gjëra: shpresa, dhembja dhe shpërblimi. Jetoje të parën, duroje të dytën, për hir të së tretës!"

2. Albana Hajraj: "Tout ira bien."

3. Albina Hajraj: "Besoni në ëndrra, sepse në to është e fshehur porta e përjetësisë!"

4. Alma Brahimi: "Through hardship to the stars."

5. Alma Çerkini: "Ti nuk je asgjë, por nuk je gjithçka. Edhe pse vjen nga asgjëja, në botë je për diçka."

6. Anisa Hoti: "Nëse me pak s'mund të thuash shumë, e shumta dëshmon se sa pak je!"

7. Artina Behrami: "Përkujto se ke lindur duke qarë kur të tjerët qeshnin nga gëzimi! Puno vepra të mira, që të vdesësh duke qeshur e ti lësh të tjerët duke qarë!"

8. Azemine Çallaku: "Mos e ndryshoni vetën për shkak se keni frikë nga ajo që thonë njerëzit! Ndryshojë vetën sepse dëshiron të jesh mirë para Allahut!"

9. Bardha Islami: "Never say never, because limits, like fears, are often just an ILLUSION!" (Michael Jordan).

10. Bleona Gashi: "Ankohemi se Zoti ka vënë gjemba poshtë trëndafilave, në vend se ta falënderojmë që sipër gjembave ka vënë trëndafila!"

11. Ebrar Esati: "Start each day with a grateful heart."

12. Edina Maloku: "A year from now you will wish you have started today."

13. Edona Hoti: "Kur do të thuash të vërtetën, përgatitu të jetosh vetëm!"

14. Eliza Shabani: "Takimet më të bukura janë ato që sjellin lot malli menjëherë pas përshëndetjes."

15. Elona Kaçiu: "Mos u bëj det t'i duash vetëm ata që dinë të notojnë, sepse të besojnë edhe ata që vetëm afër të qëndrojnë!"

16. Erblina Dibrani: "Kush nuk shijon hidhësinë e të nxëniet për një kohë, do të kapërdijë lodhjen e injorancës për gjatë gjithë jetës." (Imam Shafiu).

17. Erëza Gruda: "Nëse nuk jeton për diçka, do të vdesësh për asgjë."

18. Ermira Rrahimi: "A ship in harbor is safe, but that is not what ships are built for."

19. Erzë Pireva: "Kjo që shkruajmë e lexojmë mund të jetë e fundit. Të zgjohemi të veprojmë për gjërat që anko-hemi, sepse letra i mban, mirëpo zemra i qanë!"

20. Embëlinë Sahiti: "Po të pyes ty që po lexon këtë: A e shfrytëzove kohën në Medrese?"

21. Fatjona Rexhepi: "Fitimi më i madh në këtë botë është ta preokupohe vetën në çdo kohë me atë çka është më parësore dhe më e dobishme për ty në botën tjetër."

22. Hatixhe Hasani: "Do të kujtoj çdo gjë tënden..., në të vërtetë do të më mungojë çdo gjë e jotja."

23. Kjafete Baliu: "Mosujtja e lules nënkupton që ajo do të vyshket. Njësoj është edhe me shpirtin: ujite atë me qetësim, që të mos e përmytë sëmundja e rëndë e mërzia!"

24. Leonora Krasniqi: "Lidhuni me shokët tuaj, sepse shoku i besës është kandil ndriçues. Ndoshta nuk mund ta dallosh dritën e tij, mirëpo do ta vësh domosdo kur të të errësohet dynjaja."

25. Lirije Sopa: "Thonë se e vërteta dhemb. Ndarja nga ti vërtetë qenka e vështirë."

26. Medina Latifi: "If you never go after what you want, you will never have it."

27. Rabiye Behrami: "Anija e durimit tënd duhet t'i kalojë dallgët e sprovave."

28. Sara Ejupi: "Telling the truth and makin someone cry is better than telling a lie and making someone smile." (Paolo Coelho).

29. Semine Baftiu: "My dear, life will test just you before it will bless you."

30. Xhevahire Zeqiri: "Mos e përrjeto vetminë në rrugën e të devotshmëve, ngase në të ka pak këmbësorë!"

31. Zanfina Gashi: "And speak to people kindly!" (Al Baqarah) "Dont let their words sadden you!" (Yunus)

32. Zejnep Nika: "Me lot e fillova, me lot po e përfundoj."





10/1

Kujdestar:
Ekrem Maqedonci



10/2

Kujdestar:
Driton Arifi



10/3

Kujdestar:
Besnik Jaha







Kujdestar:
Rrahim Aliu

12/1



Kujdestar:
Muharrem Temava

12/2



Kujdestare:
Shahe Memishi

12/3



12/4

Kujdestare:
Valbona Asllani

Medresante

Ashtu sikur filloi po mbaron sot
Atë ditë ishte shi, por sot janë lot

I mjerë është ai që ty nuk ta di vlerën
Këtu gjen ngrohtësi, këtu gjen pranverën

Sa shumë ka të thuhet, për ty fjala ka vend
Tre vjet plot kujtime, që gjithmonë do mbahen mend

Me krenari mban gjithmonë një emër
Çdo këshillë e thënë, ruhet thellë në zemër

Në çdo qoshe tënden kemi një kujtim
Nuk e duam fundin, i rënd ky përfundim

Kemi nisur me lot ditët t'i numërojmë
Orët janë të shkurtra, dhe muajt shpejt po shkojnë

Mbyllet dosja jonë, por emrat s'do të harrohen
Në zemrën tënde, ajetet e fundit lexohen

Sot, të rreshtuara të gjitha, po ta kërkojmë hallallin
Si ti ndal unë lotët, si ta shuaj mallin

Të gjitha së bashku, në fundin e kësaj nate
Edhe pse largohemi, mbesim medresante

Kam shumë gjëra n'kokë, dhe s'mund t'i them në një letër
Po, mungesën tonë, do ta plotësojë gjenerata tjetër

Festina Brahimi 12/3

Maturante

Fundi shpejt vjen, e vitet po shkojnë
Atë që disa zemra deshën, kurrë nuk e harrojnë
Ato përjetime, tre vjet të plota
Nesër mua dhe ty, do të na ndaj bota
Unë në njërin skaj, ti do jesh në tjetrin
Të përqafluara fort, në heshtje ndarjen presim
Shpirti më fuqi nuk ka, andaj edhe hesht
Ndarja fizike e rëndë, ah sa pak na ka mbet'
Shikoj fotografitë, dhe shpejt i mbylli sytë
Sa e bukur koha, kur ishim në vit të dytë
Nuk e mendonim fundin, kishim tjera brenga
Të rrija më gjatë me atë shoqe, që aq shumë e desha
Koha fluturoi, ashtu, si me magji
Do të na ndajnë dallgët e jetës, se jeta ka stuhi
Kishim ëndrra, edhe dëshira të mëdha
Shumë do të mërzitem, ju pa ju pa'
Çdo gjë do të na mungojë, po ju premtoj nga zemra
Të thirrëmi edhe njëherë medresante, në ditar të kemi emra
E do të shihemi në rrugë, me shumë mall do t'përqafohemi
Sytë do t'i mbajmë mbyllur, për këtë kohë do të kujtohemi
Jemi bërë bashkë këtu, por ky s'do jetë fundi
E shfrytëzuam ca kohë, kush aq sa munda
Përsëri nuk mjafton, dua të rri më gjatë
Zgjim i përmallshëm, ai në orën shtatë
E kështu dalëngadalë, po na vjen fundi edhe ne
Unë do të qaj për ty, po aty ku je
E qan me mua në vete, nëse jo tash
Pak nga ç'do të ndodh, tani unë i thashë
Medreseja, kjo vatër diturie
Ndryshe nga fillimi, prehje përjetësie
E dini, ju mbaj në shpirt, edhe pse jo fizikisht
Do t'na ndajnë kilometrat, por jo përjetësisht
Siç e kanë thënë shumë, dhe e thonë ndër ne
Se jemi të veçantë, si sot, si dje
Dhe se këtu na piku loti, po si pikon shiu
Një zemër që ish nga jugu, dhe një tjetër nga veriu!

Edina Maloku 12/4

Erdha, për të ndenjura, e po shkoj për të mos ardhur më

Ç'vend është kjo shtëpi, më e madhe se të zakonshmet?
Shtëpi që paska një familje të madhe.
Çka ka të bëjë me të janë veç të përkohshmet.
Duket si pallati i ëndërrt i një përralle.

Ç'vend që rri si kështjellë e fortifikuar.
Dashuria për të..., e lidhur në çdo pore.
Këmbët ecin për t'u afruar-larguar...
Nuk dua të iki..., dua të rikthehem prore!

Kur erdha, në fillim m'u duk e çuditshme!
S'i kuptoja dot tërë ato zakone.
Nganjëherë na dukej e mërzitshme.
Nganjëherë na dukej monotone.

E kur filluan rrugën ta shpjegonin.
Ciceronët e të shenjtit qark.
Vetëm për të mirë, po, ata na mësonin
Ne jemi shigjeta, e ata qenë hark.

Ata që iknin, gjatë rrugës na thanë:
"Dashuria për këtë vend kurrë nuk shuhet."
Koha ikën shpejt, s'do të jesh më fazan.
Për parajsën qiellore ndjenja a përshkruhet?

Tash, kur ditët i numërojmë,
e nuk qeshim dot, veç qajmë në heshtje.
S'duam..., jo, s'duam ndarjen ta mendojmë.
Se Medreseja gjithmonë na jep buzëqeshje.

Prandaj, kështu na u bë çdo gjë mërzi.
Dhe në fytyrat gazmore s'është më ajo qeshje.
Zemrat tona, larg saj, seç ndjejnë vetmi.
Se në ditë e ndarjes pati edhe shumë reshje.

Mall për ty gjithmonë do të kemi.
Fjalët tona të fundit..., ah..., sa vështirë...
Na lejo për ty këto fjalë t'i themi:
MEDRESE..., LAMTUMIRË!

Granit Sadiku, Miran Shehu dhe Bekri Halili, 12/2

Kurani

Sa shumë libra u shtypën
Shkruhen ende e lexohen çdo orë
E si asnjëri s'na mahniti
Sa mrekullia e librit hyjnor

Literatura e filozofi
Miliona vargje e pamflete
Por asnjëra s'ta ngroh zemrën
Sa ta ngrohin ato ajete

Me fjalë nga zemra për ty shkruaj
Se fjalët për ty i përfshin bekimi
Më fal që s'mund t'i them të gjitha
Ishe dhe je larg çdo përshkrimi

Si uji i kthjellët që qartë shihet
Drita jote gjithçka përfshin
Me ato vargje të mrekullueshme
Je udhëzim për njerëzinë

Pasha diellin e paraditën
Pasha njeriun dhe shpirtin e tij
Është i verbër, edhe i humbur
Ai që s'pranon këtë mrekulli.

Ti je vetë jeta, më e ëmbla melodi
Je vetë drita që të bën të ndriçuar
U zbrit e bukura tek e bukura, mahniti
Njerëzit në mirësi për t'i ftuar

Ah si dridhet zemra kur e dëgjoj
Realitetin njerëzor nga fjala e Zotit
Sa mbledh trupi forcën e imanit
Mëkatet shkrihen nga pika e lotit

Për ta udhëzuar drejt njeriun
Fjala e njeriut nuk mjaftoi
Zoti zbriti fjalën hyjnore
"Lexo", njerëzimit i kumtoi

E një ditë si në ëndërr
Omeri i madh erdhi e m'u shfaq
"Çfarë porosie la i dërguari i Zotit
para se të vdiste?", - unë i thashë

I dërguari i Zotit po vështronte
Sytë i kthente rrotull me ngadalësi
"O umeti im", - lëshoi zërin
"Kuranin, namazin porosi!"

Ma jepni këtu atë Kuran
Se kurrë nga dora s'dua ta heq
Ma lini në gjoks sa të jem gjallë
E mos ma hiqni as kur të vdes

Granit Sadiku, 12/2

EDHE KËTË VIT U MBAJT TURNIRI NË MEDRESENË ALAUDDIN

Më datë 27.09.2018 u mbajt turniri në Medresenë Alauddin. Përveç aktiviteteve të ndryshme mësimore e edukuese, nxënësit, ashtu si edhe viteve të tjera, edhe këtë vit organizuan turnirin e futbollit. Pati lojë për disa ditë, e finalja në fund u mbajt mes klasës 12/1 dhe 12/2. Loja rezultoi me fitoren e klasës 12/1.



DITA E SHKOLLËS

Më datë 2.11.2018 u mbajt një organizim i veçantë për nder të Ditës së Shkollës. Dita e Shkollës së M.M. Alauddin në Prishtinë kësaj radhe u shënua me disa aktivitete sportive dhe argëtuese. Fillimisht drejtori i Medresesë, Jakup Çunaku, iu drejtua stafit dhe nxënësve me urimet më të përzemërta me rastin e 67 vjetorit, duke theksuar kujtimet për sakrificën dhe angazhimin e madh që kanë dhënë hoxhollarët tanë ndër vite.

Pastaj, udhëheqësit e shoqatës së nxënësve prezantuan se në cilat fusha janë planifikuar organizimet sportive, e të cilat ishin; futbollit, voleybolli, vrapimi i shpejtë, pingpongu, shah, pikado, rubikoni etj.

PËRURORHET KËNDI I LEXIMIT

Më datë 5.11.2018 u përurua këndi i leximit në Medresenë Alauddin në Prishtinë. Përfaqësues nga zyra e Bankës Botërore dhe zyra e IOM-it në Prishtinë, mësimdhënëses dhe një numër i nxënësve të Medresesë morën pjesë në përurimin e këtij këndit të leximit. Të pranishmëve fillimisht iu drejtua drejtori i Medresesë, Jakup Çunaku, i cili pasi uro mirëseardhje, ndër të tjera vuri në theks rëndësinë e librit dhe leximit për nxënësit në veçanti, dhe të gjithë në përgjithësi. Ai vlerësoi lartë përurimin e këndit të leximit, që tani e tutje do të jetë edhe një mundësi shtesë e leximit për medresistët. Të pranishmëve më një fjalë rasti iu drejtua edhe përfaqësuesja e IOM-it në Prishtinë, duke ndarë me të pranishmit përshtypjet e mira për medresistët që ishin pjesëmarrëse në këtë projekt. Po ashtu, edhe përfaqësues nga Banka Botërore, zyra në Prishtinë, që bashkë me IOM-in sponsorizuan këtë projekt, ndau urimet për shkollën dhe nxënësit. Ky projekt është realizuar falë punës dhe angazhimit të një grupi të nxënësve të Medresesë Alauddin dhe mësimdhënëses Fikrije Dumani-Krasniqi, të cilat kishin aplikuar për mbështetje financiare për këtë projekt. Projekti përfshinte furnizim me qindra tituj të librave nga fusha të ndryshme, si dhe ndërtimin e këndit të leximit.



MYFTIU TËRNAVA VIZITON MEDRESENË

Më datë 14.11.2018 Medresenë Alauddin e vizitoi myftiu i Republikës së Kosovës, Naim ef. Tërnavë. Pas leximit të disa ajeteve kuranore prej nxënësit Gentrit Osmani, drejtori i Medresesë Jakup Çunaku i uroi mirëseardhje myftiut Tërnavë, dhe në emrin e shkollës i uroi rizgjedhjen në pozitën e Kryetarit të BIRK-ut edhe për një mandat. Pas kësaj drejtori hapi bisedën me myftiun, duke kërkuar prej tij të ndajë disa përvoja personale, duke qenë si ish-medresist, e pastaj mësimdhënës dhe drejtor i Medresesë për disa vite.

Myftiu Tërnavë shprehu kënaqësinë e tij që ishte në Medrese, dhe tha se kjo shkollë, në çdo kohë dhe rrethanë, ka dhënë kontributin e vet për edukim fetar dhe atë kombëtar. Ai i porositi nxënësit që edhe më tej të angazhohen në mësimin e drejtë të parimeve fetare nga bankat e kësaj shkolle, dhe porositi për kujdes të veçantë në mësimin e çështjeve fetare. "Së bashku, dhe me ndihmën e Zotit, të punojmë shumë, që ta ndërtojmë këtë shoqëri tutje, me vlerat tona kombëtare e fetare, dhe të jemi akterë të rëndësishëm në të ardhmen brenda trojeve tona! Vlerat tona, si: morali, respekti, nderi, besa dhe shumë të tjera, nuk duhet anashkaluar asnjëherë", tha mes tjerash myftiu i Republikës së Kosovës.



FILLON KURSI PËR MEMORIZIMIN E KURANIT - HIFZ

Më datë 19.10.2018, në shkollën tonë u hap një kurs i veçantë për memorizimin e Kuranit fisnik, të cilin kurs vazhdojnë ta ndjekin shumë nxënës.



EDHE KËTË VIT MEDRESEJA DHE DKA NË PRISHTINË ORGANIZUAN FESTIVALIN E RECITATORËVE

Më datë 20.03.2019 në Medresenë Alaudin, si edhe vitin e kaluar, u mbajt Festivali i Recitatorëve. Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës dhe Medreseja e Mesme Alauddin, edhe këtë vit, për nder të 21 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Poezisë, të mërkurën organizuan Festivalin tradicional të Poezisë, organizim ky që mbledhi 72 nxënës garues nga të gjitha shkollat e mesme të ulëta dhe shkollat e mesme të larta të komunës së Prishtinës. Të gjithë këta nxënës u paraqitën me poezi të ndryshme, duke shfaqur talentin dhe shkathësitë e tyre në recitim.

Në këtë ngjarje ishte e pranishme edhe drejtoresha e DKA-së në Prishtinë, znj. Shpresa Shala, e cila me këtë rast, në fjalën e saj për hapjen e garës, vuri në theks vlerën e madhe kulturore dhe edukative që bën kultivimi i fjalës së bukur, recitimi i poezisë dhe edukimi estetik. "Si Drejtori e Arsimit ne e çmojmë çdo aktivitet që kontribuon në ngritjen e cilësisë së arsimit dhe edukimit të gjeneratave", tha ndër të tjera drejtoresha Shpresa Shala.

Të pranishmit me një fjalë rasti i përshëndeti edhe drejtori i M.M. Alauddin, z. Jakup Çunaku, i cili përveç urimit të mirëseardhjes, tha: "Poezia është mbretëreshë e artit, prandaj duhet përqendruar edhe më shumë në këtë fushë me nxënësit tanë".

Për përzgjedhjen e tre recituesve më të mirë në nivel të komunës së Prishtinës vendosi juria profesionale e zgjedhur nga DKA e Prishtinës, e cila ishte e përbërë prej: Prof. Besnik Jaha, Prof. Melihate Zeqiri dhe Prof. Shyhrete Alaj. Në këtë Festival, sipas jurisë, më të mirët ishin nxënësit:

- Aurora Aliu, M.M. "Alauddin", - Vendi i parë
- Ruvejda Jaha, shkolla "Hasan Prishtina", - Vendi i dytë
- Leon Biçaku, shkolla "Iliria", - Vendi i tretë



U MBAJTËN GARAT E DIJES NË MEDRESENË ALAUDDIN

Më datë 13 prill 2019 në Medresenë Alauddin u organizuan Garat e Dijes në nivel shkolle. Kësaj radhe organizmi i tyre ishte më ndryshe se viteve paraprake. Fillimisht komisioni i Garave të Dijes mori vendim që këto të zhvillohen në gjashtë (6) lëndë si: Gjuhë shqipe, Gjuhe angleze, Gjuhë arabe, Akaid, Fikh dhe Histori. Nga secila lëndë ishin nga pesë (5) pyetje në materialin e zhvilluar në nivel të paraleles. Pra, ishte një test me shkrim, i përpiluar me shumë kujdes, me gjithsej 30 pyetje nga lëndët e lartpërmendura.

Pjesëmarres ishin 67 nxënës: nga paralelja amë 39 nxënës; nga ajo e Prizrenit ishin 16 ,dhe; nga e Gjilanit 12 nxënës.

Në hapjen zyrtare të këtyre garave ishte edhe Kryei-
mami i BIK-ut, Sabri ef. Bajgora, i cili ndër tjera tha: “Im-
perativi i parë i fesë sonë është “lexo”, andaj duke lexuar
e njohim edhe më mirë Zotin tonë, dhe do të jemi më të
suksesshëm në jetën tonë.” Kurse drejtori i M. M. Alaud-
din në Prishtinë, Jakup Çunaku, pasi përshëndeti dhe
uroi nxënësit për këto gara, shtoi: “Do të punojmë edhe
më shumë në ngritjen e cilësisë së arsimit në shkollën
tonë. Një ndër mënyrat e ngritje së arsimit është edhe
bashkëpunimi i ndërsjellë ndërmjet paraleleve tona, siç
janë edhe këto gara të dijes.”

Pastaj garuesit iu nënshtruan testin nëpër klasë, për 90 minuta. Përgjigjet e tyre u vlerësuan prej mësimeve të tyre kompetentë të Medresesë, dhe dolën këto rezultate:

Klasat e 10-të

Vendi i I – Amira Dërguti (273.5 pikë) nga klasa 10/4

Vendi i II – Anisa Dërguti (269 pikë) nga klasa 10/4

Vendi i II – Diellza Ibrahim (262 pikë) nga klasa 10/5

Klasat e 11-të

Vendi i I- Samir Olluri (287 pikë) nga klasa 11/2

Vendi i II – Aida Hashani (275 pikë) nga klasa 11/4

Vendi i II – Yllka Llapashtica (271 pikë) klasa 11/3

Klasat e 12-ta

Vendi i I- Dren Lipaj (246 pikë) nga klasa 12/2

Vendi i II – Fatime Sylka (241 pikë) nga klasa e 12/6

Vendi i II – Hatixhe Hasani (238 pikë) klasa e 12/4

Në fund Drejtoria e shkollës ndau mirënjohje për të gjithë garuesit, e në veçanti për fituesit ndau mirënjohje dhe dhurata.

Krejt në fund, në restorantin e shkollës sonë u shtrua edhe një drekë për nxënësit dhe mësimdhënësit e M. M. Alauddin. / Redaksia



MË DATË 25.04.2019 NGA KRYQI I KUQ U ORGANIZUA GARA KOMUNALE PËR NDIHMËN E PARË

Në këtë garqë morën pjesë nxënësit: Granit Sadiku, Miran Shehu, Dren Lipaj, Mumin Baftiu, Indrit Gashi dhe Qëndrim Sylja. Nxënësit patën për detyrë fashimin e plagës së shuplakës së dorës. Pas një pune korrekte dhe me përkushtim, medresistët e fituan vendin e dytë në nivel komunal. Vendin e parë e mori shkolla "Ali Sokoli", ndërsa vendin e tretë, shkolla "Eqrem Çabej". Medresistët edhe një herë e dëshmuar kapacitetin e tyre, dhe jo vetëm në lëmin fetar, por edhe në atë shkencor. Kjo ishte hera e tretë që medresistët marrin pjesë në këtë garë.



PËRURORHET LIBRI PËR MEDRESENË ALAUDDIN

Më 16.05.2019, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës nxori në qarkullim librin me përmbledhje të kumtesave nga Konferenca shkencore "Medreseja Alauddin e Prishtinës, 65 vjet në shërbim të arsimit fetar dhe kombëtar". Libri ka 560 faqe, ku janë përfshirë fjalët përshëndetëse të prijësve të komuniteteve fetare e akademike, si dhe rreth 52 kumtesa të mbajtura në Konferencën e 17-19 majit 2017. Libri përmbyllet me dy shtojca: e para sjell faksimile e foto dokumentare nga historiku i bujshëm i Medresesë, ndërsa e dyta foto tregon momentet kryesore të Konferencës. Librin mund të sigurohet në selitë e këshillave të BIK, si dhe në pika të tjerat shitëse.



KRYETARI I KUVENDIT TË KOSOVËS, KADRI VESELI ME BASHKËPUNËTOR BËN IFTAR ME NXËNËSIT E MEDRESESË “ALAUDDIN” NË PRISHTINË

Kryetari i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu Naim ef. Tërnavë, dhe kryeparlamentari Kadri Veseli me disa bashkëpunëtorë, bënë iftar me nxënësit e Medresesë “Alauddin” në Prishtinë.

Në emër të drejtorit të Medresesë dhe stafit e nxënësve të “Alauddinit” në Prishtinë, mysafirëve mirëseardhje u dëshiroi sekretari Sulejman Osmani, i cili i falënderoi mysafirët për pjesëmarrje në këtë iftar të përbashkët.

Më pas një fjalë rasti mbajti myftiu Tërnavë, i cili uroi për Ramazanin, duke lutur Zotin që agjërimin dhe duatë të na i pranojë. Ai më pas falënderoi kryetarin e Kuvendit, Kadri Veseli, me bashkëshorten, pastaj ministrin Uran Ismaili, me bashkëshorten, si dhe bashkëpunëtorët e tyre për pjesëmarrjen në këtë iftar. Ai më pas tha se Medreseja është një vatër e dijes dhe e çështjes kombëtare, që për dekada tregoi se është e pathyeshme, duke dhënë një kontribut karshi të gjitha furtunave që vinin në drejtim të saj nga okupatori i atëhershëm serb.

Në anën tjetër, kryeparlamentari Veseli konfirmoi rolin që ka luajtur Medreseja në shtetëndërtimin e Kosovës, po edhe në edukimin e mirëfilltë të brezave. “Nga këtu dolën shumë teologë e atdhetarë, e të cilët shërbyen në çlirim dhe ndërtimin e vendit tonë”, tha ndër të tjera kryeparlamentari Veseli.

Në fund të iftarit disa prej nxënësve paraqitën një program të shkurtër artistik, me disa poezi e ese. Krejt në fund për kryetarin e Kuvendit, z. Veselin, pati dhuratë: një mirënjohje me mbishkrimin “Shehidët medresantë”.



MEDRESEJA ALAUDDIN MBAN PROGRAM PËR NDER TË DITËLINDJES SË MUHAMEDIT A.S. DHE 28 NËNTORIT

Për nder të ditëlindjes së Muhamedit, a.s., dhe festës së 28 Nëntorit, Medreseja organizoi program kulturor dhe ligjërata speciale. Programi u begatua edhe më me prezencën e krerëve të Bashkësisë Islame të Kosovës, përfaqësuesve nga Ministria e Arsimit e Kosovës, pastaj nga Dijanet-i dhe Yunus Emre, Stacioni policor nr. 3 në Prishtinë, Qendra e Mjekësisë Familjare në Prishtinë, si dhe qytetarë të shumtë. Më një fjalë, ky program kishte për synim komunitetin që gjendet gjithnjë afër nesh. Të pranishmit me një fjalë rasti i përshëndeti myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, si dhe drejtori i M. M. Alaudin, Jakup Çunaku, ndërsa kryeimami i BIRK-ut, Sabri ef. Bajgora mbajti një ligjëratë të shkurtër dhe të thukët për jetën dhe veprën e Muhamedit, a.s.

Pas kësaj të pranishmit patën rastin të kalojnë çaste të këndshme duke ndjekur programin artistik të përgatitur prej nxënësve të shkollës, për t'u ndarë në fund tepër të kënaqur.



PROMOVOHET ROMANI "ENGJËLLI I KOHËS", I NXËNËSIT GRANIT SADIKU

Ndër aktivitetet e shkollës sonë ishte edhe promovimi i romanit "Engjëlli i kohës", të autorit Granit Sadiku. Kjo ngjarje ndodhi më datë 30 maj 2019, në ambientet e Medresesë Alauddin. Romani në fjalë flet për historinë e një djaloshi të dëshpëruar nga jeta, dhe ngre çështjen filozofike të dashurisë ndaj vendit. Romani i ka tetëmbëdhjetë kapituj (ndërlidhje kjo e cila ta kujton moshën e autorit), dhe flet për çështje të ndryshme, e të cilat e preokupojnë të riun kosovar. Në këtë roman, siç u shpreh në fjalimin e tij profesor Besnik Jaha, shohim diapazonin e gjerë të Granitit, dhe po ashtu leximet e shumta të tij. "Aty gjejmë Sokratin, Aristotelin, Danten, Tolstoin, Dostojevskin, Hessen, Qosjen, Kadarenë etj. Autori i librit, përveç leximit të këtyre autorëve, ka arritur që edhe tekstet e tyre t'i futë si intertekst brenda romanit të tij (e që është njëra ndër format e letërsisë bashkëkohore)", tha ndër të tjera profesor Besnik Jaha. Romani u botua nga Shtëpia Botuese "Dituria Islame". Autori, përveç këtij romani ka shkruar edhe shumë tekste të tjera, dhe vazhdimisht është shprehur se ndër frymëzimet e tij kryesore për të shkruar ka qenë "shtëpia e tij e dytë", siç e quan ai Medresenë Alauddin. / Redaksia



NXËNËSI I MEDRESESE, AMAR RAMA, KRYETARI I PARË I KNP-SË

Amar Rama është kryetari i parë i Këshillit të Nxënësve të Prishtinës nga Medreseja Alauddin. Ai ka arritur të realizojë shumë aktivitete përgjatë mandatit të tij, dhe ka pasur suksese nga më të ndryshmet.

Në punën e tij si udhëheqës i këtij Këshilli, primare ka qenë vetëdijësimi i nxënësve, inkurajimi dhe motivimi i tyre, që ata të arrijnë në piedestalet më të larta në rrugën e tyre.

Në KNP nxënësi Amar Rama ka zhvilluar një sërë aktivitete, falë edhe përkrahjes nga kryesia dhe anëtarët e tjerë të këtij Këshilli. Shkolla falënderon kryetarin dhe anëtarët e tjerë, si prej nxënësve tanë apo edhe nga shkollat e tjera, për përfaqësim të denjë në këtë Këshill. / Redaksia



LEDION SPAHIU, KAMPION KOSOVE NË ATLETIKË, NË KATEGORINË U16

Ledion Spahiu është nxënës i klasës 10/3. Me këtë sport Ledioni ka filluar të merret qysh nga viti 2012, kur në komunën e Podujevës, siç thotë, ai mbahej një garë për Atletikë me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. “Pasi babai im kishte vërejtur një talent të theksuar tek unë, pra në sport, në vrapim, më propozoi të merrja pjesë në këtë garë. Kjo garë ishte gara ime e parë, dhe e cila rezultoi me marrjen e vendit të parë në vrapim, në nivel komunal. Prej kësaj kohe ka filluar dëshira ime për Atletikë, dëshirë të cilën e kam të mbitheksuar sidomos në dy vjetët e fundit, dhe dëshirë e cila më ka çuar deri te rruga e të qenit kampion Kosove në Atletikë”, thotë Ledioni. Pas këtyre sukseseve, ky sportist i ri planifikon ta përfaqësojë Kosovën në gara ndërkombëtare, në disiplinën e vrapimit, kategoria U19. Redaksia e revistës sonë i dëshiron shumë suksese! /Redaksia.



ELION VITIA, SPORTIST GJIMNASTIKE QË PREMTON SHUMË

Elion Vitia është nxënës në klasën 10/1. Hobi i tij është Gjimnastika. Fillimi i marrjes me Gjimnastikë ka qenë nga 21 shtator 2014, kur në sheshin “Nënë Tereza”, në Prishtinë, mbahej një garë në Akrobacion. Kjo garë e ka ndihmuar atë shumë që të përcaktohej në këtë drejtimin. Kur organizatorët e këtij programi vërejtën talentin e tij, e thirrën që të merrte pjesë në gara të tjera të organizuara. Dhe, kështu filloi angazhimi i tij më i theksuar në këtë sport.

Në gara të shumta që mbahen në Kosovës, Elioni ka korrur suksese të kënaqshme. Ai planifikon të marrë pjesë në garat në nivel Kosove, e të cilat mbahen më 1 qershor. Ndërkaq, më 24 korrik 2019 Elioni planifikon të marrë pjesë në gara ndërkombëtare. / Redaksia



PROGRAMI MIRËPRITËS PËR GJENERATËN E RE

Me rastin e ardhjes së gjeneratës së 20-të me radhë nga paralelja e vajzave në M.M. Alaudin në Prishtinë, nxënëset e klasave të dymbëdhjeta, në bashkëpunim me klasat e njëmbëdhjeta, ripërtërinë traditën dhe përgatitën një program modest kulturor-argëtues për të uruar mirëseardhje për gjeneratën e re. Kësaj radhe mysafirë special ishin nxënëset e klasës së dhjetë nga Gjilani, ku për herë të parë u hap paralelja e vajzave, e të cilat na nderuan me pjesëmarrjen e tyre.

Të pranishëm ishin drejtori i M.M. Alaudin në Prishtinë, Jakup Çunaku, si dhe kuqdestarët e paraleleve të vajzave, si dhe disa mësime të tjerë. Si çdoherë programi u hap me lexim të fjalës së Allahut, xh.sh., dhe vazhdoi me disa përshëndetje të drejtorit dhe kujdestarëve. Pastaj, programi i përgatitur enkas,

edhe pse ishte modest, ishte i larmishëm me pikat si: ilahi nga kori i vajzave, monolog, poezi, si dhe pika të ndryshme argëtuese.

Në fund nxënëset uruan shëndet dhe suksese për të gjitha nxënëset, me shpresë për shëndet dhe shumë takime të ngjashme.




NË AMBIENTET E MEDRESESË U MBAJT NJË AKTIVITET NË LËNDËN E AKAITIT

Aktiviteti i organizuar në lëndën e Akaidit (besimit), që si e tillë është ndër më të rëndësishmet në kuadër të shkencave islame, u prit me mjaft interesim nga ana e nxënësve.

Pas leximit të fjalëve nga Kurani famëlartë, fjalën e mori drejtori i Medresesë Mr. Jakup Çunaku. Drejtori përshëndeti stafin edukativo-arsimor, nxënëset, si dhe një falënderim të veçantë shprehu për profesoreshën e Akaidi, Fikrije Dumani-Krasniqi, si dhe për paralelet e klasave të dhjeta, duke shprehur gjithashtu edhe gatishmërinë e tij për përkrahje të vazhdueshme. Ai, ndër të tjera, tha: "Kanë kaluar vetëm dy muaj e dhjetë ditë, dhe ja, i shohim nxënëset tona të aktivizuara në aktivitete. Kjo është një nismë e mirë, dhe model i suksesshëm."

Pastaj, nxënëset vazhduan aktivitetin e tyre me pikat e përgatitura, e ku paraqitën argumentet fetare, logjike dhe shkencore që Zoti ekziston. Nëpërmjet këtij aktiviteti u demonstrua praktikisht cilësia e Allahut "El Vuxhud".



"MA RRËFE QËNDRIMIN E ZOTIT PËR VEPRËN TIME!"

Më datën 13.03.2019, në amfiteatrin e Medresesë u mbajt një aktivitet mësimor nga paralela e vajzave, respektivisht nga klasa e 12/3 dhe 12/4, në lëndën e Usuli Fikhut-Bazat e Jurisprudencës Islame. Aktiviteti ishte emërtuar me titullin-sloganin: "Ma rrëfe qëndrimin e Zotit për veprën time!"

Gjatë këtij aktiviteti nxënëset paraqitën përmes disa sllajdeve dhe videove, në mënyrë tejet kreative, këndvështrimet e tyre rreth disa çështjeve thelbësore të kësaj shkence, e cila në Medrese mësohet vetëm në klasën e 12-të.

Aty u demonstrua edhe në formë praktike mënyra e nxjerrjes së normave juridike islame nga burimet juridike islame. Ishin nxënëset e klasave më të ulëta ato që pyesnin për disa çështje të një rëndësie të veçantë, dhe të njëjtave iu përgjigjeshin nxënëset maturante, duke u bazuar në njohuritë e tyre që kishin marrë tashmë në lëndën e Usulit. Ky program u mundësua edhe falë përkrahjes së profesorëve të kësaj lënde, prof. Driton Arifit dhe prof. Valbona Asllanit. Gjatë këtij programi ishte profesoresha Asllani ajo që iu drejtua me një fjalë inkurajuese nxënësve, duke shprehur kënaqësinë që ishte pjesë e një projekti kaq me vlerë për nxënëset dhe shkollën tonë.



MEDRESEJA ALAUDDIN KULTIVUESE E ARTEVE

Medreseja Alauddin, përveç mësimi shkencor dhe fetar, është edhe vatër e arteve të ndryshme. Këtë më së miri e vërtetojnë nxënësit dhe nxënëset e kësaj shkolle. Shembull i fundit është edhe fitimi i vendit të parë në Festivalin e Recitatorëve të shkollave të mesme të Prishtinës, të organizuar nga Medreseja Alauddin dhe Drejtoria për Arsim e Komunës së Prishtinës, nga nxënësja jonë Aurora Aliu, si dhe pjesëmarrja e ngushtë në garë e nxënësit Kasim Gërbeshi dhe Miran Shehu, njësoj sikurse edhe suksesi i nxënësve Mirvete Karaliti 12/3 dhe Kaltrina Kosumi 12/3, që me esetë e tyre qenë shumë të suksesshme në garën e organizuar nga Qendra Social-Edukative "Don Bosko".

Esetë e vajzave të shkollës sonë u përzgjedhën ndër më të mirat në mesin e më shumë se 90 garuesve të komunës së Prishtinës. Ato u zgjedhën ndër dhjetë esetë më të mira, në garën e cila u organizua për nder të Ditës së Poezisë, me 15.03.2019. Shpërndarja e mirënjohjeve u bë me 22.03.2019, në Qendrën "Don Bosko", ku u organizua edhe Tryeza e Rrumbullakët, me temën "Trajektorja e gruas shqiptare dhe emancipimi i saj ndër shekuj". Tema e esesë në këtë garë ishte "Udhëtimi përtej asaj që jam".



VIZITA E Z. SALAM AL MARAYATI

Medresenë Alauddin në Prishtinë e vizitoi z. Salam Al Marayati, kryetar i Këshillit të Çështjeve Publike të Myslimanëve në Amerikë (MPAC)

Ai fillimisht u prit nga drejtori i M.M. Alauddin në Prishtinë, z. Jakup Çunaku me bashkëpunëtorë, i cili pasi i shprehu mirëseardhje, e njoftoi për procesin mësimor dhe rreth dhe historikun e shkollës sonë. Pastaj u takuan edhe me kolektivin arsimor të shkollës, si dhe vizituan disa klasë mësimi.

Po ashtu z. Salam në amfiteatrin e shkollës sonë bashkëbisedoi me nxënësit tanë, për temën "Të rinjtë myslimanë në Amerikë, dhe roli i tyre udhëheqës", e që edhe ndau përvojën e tij jetësore se si një mysliman në ShBA mund të japë kontribut për të mirën e shoqërisë pa dallim feje, etnie dhe gjuhe. Ai njëherazi pranoi një sërë pyetjesh prej nxënësve të shkollës sonë, dhe u nda shumë i kënaqur me aktivizimin e tyre në diskutim.



AKTIVITETE SPORTIVE- TURNIRET E VOLEJBOLLIT

Këtë vit M.M." Alauddin"- paraleleja e vajzave në Prishtinë, pati një vit të mbushur me aktivitete, e prej tyre edhe me ato sportive. Këtë vit u mbajtën disa turnirë në sportin e volejbollit. Fillimisht me datën 02.10.2019, me rastin e manifestimit të përvjetorit të 67-të të Medresesë, u mbajt turniri në mes klasave në paralelen e ndarë në Prishtinë, e ku rezultatet e këtij turniri ishin:

Vendi i parë: Klasa 10/4

Vendi i dytë: Klasa 11/3

Vendi i tretë: Klasa 12/4

Në po këtë ditë u mbajt edhe një garë arti, e ku punimi më i mirë u zgjodh ai i Anisa Berishës, nga klasa 11/3.

Po ashtu, më datë 06.02.2019, Medresenë "Alauddin", në bashkëpunim me Këshillin e Nxënësve të Prishtinës, u organizua turniri i radhës në kuadër të shkollave të mesme të Prishtinës, e ku rezultatet ishin:

Vendi i parë: Gjumnazi "Sami Frashëri"

Vendi i dytë: Gjumnazi "Eqrem Qabej"



Vendi i tretë: Gjumnazi "Xhevdet Doda".

Në fund për fituesit u ndanë mirënjohje.

Dhe në fund, më datën 13.04.2019, përgjatë zhvillimit të garave të dijes, u organizua edhe turniri në volejboll, në mes paraleleve të vajzave nga Prishtina, Prizreni, dhe për herë të parë edhe nga paralela e Gjilanit.

Mbi të gjitha, përveç argëtimit të nxënësve, këto turnire ishin edhe rast për njohje dhe miqësim mes shkollave dhe vajzave.

"MBRETËRESHA E LËNDËVE"

Medreseja është e njohur me aktivitetet të shumta fetare e shkencore, ndër to ishte edhe programi në lëndën e Matematikës. Ky program u mbajt në amfiteatrin e vajzave, e ku të pranishëm ishin drejtori Jakup ef. Çunaku, profesorët, profesoreshat, si dhe nxënësët e shkollës. Nxënësët prezantuan punime të ndryshme me tema të si: Historiku i shkencës së Matematikës, Teorema e Pitagorës, lidhja e Matematikës me Arkitekturën, zbulimet e ndryshme në këtë shkencë etj.

Me projektor paraqitën edhe punime të bëra me dorë, si vërtetime dhe argumente që kanë të bëjnë me "Mbretëreshën e lëndëve": Matematikën.

Ia vlen të përmendet se prapa gjithë kësaj pune ishte prof. Marigonë Gashi, e cila nuk u lodh duke qëndruar afër nxënësve për realizimin e këtij aktiviteti. Në këtë program morën pjesë të gjitha klasat me përfaqësueset e tyre. Programi u pasua me poezinë e recituar nga nxënësja Mirvete Karaliti. Në fund të programit, për ta pasuruar edhe më shumë këtë program, nxënësja Fatjona Rex-

hepi zgjodhi një detyrë logjike. Pjesë e programit ishte edhe një anketë e bërë prej nxënësve Edina Maloku dhe Rabije Behrami, rezultatet e së cilës ishin mjaft të kënaqshme. Programi u përmbyll me paraqitjen e disa argumenteve kuranore që kanë të bëjnë me Matematikën si shkencë.



MBAHET DUAJA E HATMES E GJENERATËS SË 52-TË

Më datë 25.04.2019 u mbajt manifestimi i Duasë së Hatmes nga gjenerata e 52-të e nxënësve të Medresesë Alauddin. Falë Zotit, medresistët arritën që ta përfundojnë tërësisht leximin e Kuranit, dhe këtë sukses të tyre ta kurorëzojnë me Duanë e Hatmes. Programi pati përmbajtje të bukur fetare, kulturore dhe artistike: fillimisht medresistët lexuan pjesën e fundit të Kuranit, që iu kishte mbetur, pastaj nxënësi Jasin Abazi e lexoi duanë në gjuhën arabe, ndërsa nxënësi Miran Shehu e lexoi të përkthyer në gjuhën shqipe. Pastaj moderatorët, Dren Lipaj dhe Mumin Baftiu, e ftuan drejtorin e Medresesë, Jakup ef. Çunaku, për një fjalë rasti. Drejtori u shpreh se është një ndjenjë e veçantë kur mësuesit i shohin nxënësit e tyre në majat e suksesit. Ai theksoi se kjo gjeneratë la gjurmë të mëdha në historinë e Medresesë. Drejtori e falënderoi edhe Bashkësinë Islame, myftiun Naim ef. Tërnavë, për mbështetjen e tyre që ia kanë dhënë Medresesë.

Pas fjalimit të drejtorit, skena iu dha myftiut të Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, Naim ef. Tërnavë i cili ndër të tjera tha se është vërtet për t'u vlerësuar ajo që dëgjuam sot nga këta nxënës këtu. Dhe me të vërtetë këta nxënës janë për t'u pasur lakmi. Duhet dhënë falënderim të veçantë për profesorët, jo vetëm ata të Kuranit, por edhe për ata të lëndëve të tjera. Myftiu e përmbylli fjalimin e tij duke shtuar se BIK-u do të jetë gjithmonë në mbështetje të shkollës dhe nxënësve të saj.

Pas myftiut Tërnavë, fjalimi i profesorit Bahri Simnica ishte fjalim për t'u mbajtur mend si kujtimi më emocional në shkollë, ku ndër të tjera tha: "Më kujtohen hoxhollarët tanë të vjetër, që ne i kemi pasur mësues. Si, për shembull: Hasan efendiu, Mulla Sherifi, Mulla Sadriu etj. Ata na thoshin: "Pasha Zotin, ju duam më shumë sesa fëmijët tanë!" Realisht, për kohën që ishim, na dukej pak e tepërt. Tani e kuptoj. Ata na thoshin se na donin më shumë sesa fëmijët e tyre. E unë po them se këta i duam më shumë se gjithçka në këtë botë. E pyeta profesorin Driton: "A ke munguar në ndonjë orë?" Më tha: "Në asnjë orë." I thashë: "Edhe unë në asnjë orë." A nuk do të thotë kjo se s'kemi qenë kurrë të sëmure?! A do të thotë se nuk kemi probleme të natyrave të ndryshme, siç i ka çdo njeri?! Dëshira që të jemi me nxënësit tanë, që t'i rrimë besnik amanetit që e kemi marrë, edhe sëmundje kur kemi pasur, na ka bërë të paraqitemi në orë. Prandaj, unë këtyre nxënësve u kërkoj shumë falje, për shkak se mësuesi që është gjithmonë i rregullt,



nxënësi nuk e ka fort qejf. Dashtë Zoti që të kenë shëndet, dhe të jenë shumë më të mirë sesa ne! Dikur të vije në Medrese ishte çmenduri, kurse tani është krenari.", tha mes tjerash profesori Simnica. Ishte e pamundur të mos kishte lot pas këtij fjalimi të profesorit Bahri Simnica. Edhe profesori vetë, që nuk ishte mësuar askush t'ia shihte ndryshe tenin e fytyrës, veçse serioz, bëri atë që askush nuk e priste: qau.

Pasi përfundoi edhe fjalimi i profesorit Bahri Simnica, skena ishte për pikat artistike. Në fillim doli nxënësi Miran Shehu, i cili e lexoi esenë e tij kushtuar Medresesë Alauddin "Sekretet e fundit", e pastaj kori i Medresesë Alauddin këndoi ilahi. Në vazhdim, nxënësi Granit Sadiku recitoi një poezi që e kishte shkruar për Kuranin "Fjalët për ty i përfshin bekimi". Krejt në fund, me një fjalë përshëndetëse publikut iu drejtua edhe kryetari i Këshillit të Prindërve të Medresesë Alauddin, z. Basri Sadiku, i cili i përshëndeti prindërit dhe nxënësit, duke i uruar të gjithë për shëndet dhe të gjitha të mirat gjatë jetës së tyre.



NJË DITË KU ZEMRAT TROKASIN NDRYSHE - DUAJA E HATMES E VAJZAVE

Më 26 prill 2019, në ambientet e amfiteatrit të Medresesë së Mesme Alauddin u mbajt ceremonia e Duasë së Hatmes e maturanteve të këtij viti. Salla ishte e vogël për t'i akomoduar mysafirët e shumtë që kishin ardhur në këtë manifestim. Fillimisht nga maurantet u lexuan disa pjesë nga Kurani fisnik, e me këtë pjesë u përmbyll edhe simbolikisht përfundimi i leximit të Kuranit. Pastaj drejtori i Medresesë, Jakup ef. Çunaku, i uroj nxënëset për këtë sukses, duke shprehur urimin për shëndet dhe suksese në të ardhmen e tyre. Udhëheqësja e Departamentit të Gruasë në BIK, znj. Vaxhide, i uroi vajzat, dhe i siguroi se ato kanë një të ardhme të ndritur. Mësimdhënësja, znj. Valbona Asllani, në emër të mësimdhënësve të Kuranit tregoi përvojën e tyre me këto vajza në lëndën e Kuranit, dhe shtoi se ato ishin një nga grupet e njerëzve që do të respektohen edhe nga engjëjt. Pas kësaj vazhdoi një program simbolik i përgatitur prej nxënësve, e ku u paraqitën pika të ndryshme me ilahi e monologë nga kori i vajzave.

Në shenjë falënderimi, nxënëset ndanë edhe dhurata për dy mësimdhënësit e Kuranit, profesor Bahri Simnicën dhe profesorëshën Valbona Asllani.

Në fund, shkolla ndau mirënjohje dhe shpërblime edhe për nxënëset më të mira në këtë vit shkollor, e ato ishin:

- 10-4 Amira Dërguti
- 10-5 Shukrane Tahiri
- 11-3 Yllka Llapashatica
- 11-4 Aida Hashani
- 12-3 Semire Hyseni
- 12-4 Erblina Dibrani.

Kurse, në nivel të paraleles së vajzave, nxënësja Mirvete Karaliti 12/3 i shpall si më e mira e këtij viti shkollor. Me kaq përfundoi Duaja madhështore e Hatmes së Kuranit nga gjenerata e 18-të. Krejt në fund u shtrua edhe një drekë për mysafirët e shkollës sonë.



UDHËTIMI NË TURQI



Një nga ngjarjet kryesore për maturantët pa dyshim që është ekskursioni, e që në Medrese edhe këtë vit u zhvillua në shtetin e Turqisë. Më 29.04.2019 maturantet, nën shoqërimin e kujdestarëve, u nisën për të realizuar udhëtimin e tyre të fundit si medresiste. Pas arritjes në Turqi, u vendosëm në shkollën “Şehit Mehmet Karaaslan Uluslararası Kız Anadolu Imam Hatip Lisesi”, ku u mirëpritën në mënyrën më të mirë. Pas disa orëve pushimi vizituan Festivalin Ndërkombëtar të Përfaqësimit të Shteteve, e ku u njohëm me kultura të ndryshme.

Të nesërmen morën rrugën drejt dy xhamive më të famshme, asaj “Aya Sofya”, e cila është qindravjeçare, dhe tjetrës afër saj, xhamisë “Sultan Ahmet”, e cila po ashtu mahnit secilin me bukurinë e saj. Po këtë ditë vazhduan rrugën drejt xhamisë “Fatih Süleymaniye”, e cila përveç pamjes së saj të bukur, ofroi edhe një pamje magjepsëse të bregdetit.

Ditët në vazhdim nxënëset vizituan disa vende shumë interesante, e prej tyre edhe parkun mahnitës “Emirgan”, ku kaluan një kohë shumë të mirë. Më vonë vizituan edhe xhami, kisha e lagje të ndryshme, e prej tyre “Lagjen Çukur”, kodrën “Hz. Yusa tepesi”, si dhe bastionin “Yolos kalesi”, ku u njohën me kulturën antike e tradicionale të shtetit turk.

Ky udhëtim pa dyshim se ishte njëri ndër udhëtimet më të bukura për nxënëset e shkollës sonë, e që do të jetë i paharrueshëm për çdo moment të tij. Sipas nxënëseve, këtë ekskursion do ta mbajnë mend si një ndër momentet më të bukura të këtyre tri viteve. Falënderojmë shkollën tonë, që na e mundësoi realizimin e këtij udhëtim kaq të bukur!



UDHËTIMI MË I BUKUR NË JETË



Me datë 22 tetor 2018, nxënësit e Medresesë Alauddin shkuan në Turqi për ekskursion. Gjatë këtij ekskursioni nxënësit patën rastin të vizitonin vende të ndryshme, si dhe të shihnin xhami të vjetra, të njiheshin për historikun e tyre më në detaje etj. Gjatë këtij ekskursioni nxënësit mësuan edhe për periudhën e rëndësishme islame, e që ishte periudha e Perandorisë Osmane. Privilegji që gëzon Medreseja Alauddin dhe nxënësit e saj po ashtu ishin prej arsyeve kryesore që medresistët u pritën më së miri në çdo vend që shkonin, dhe gëzonin respekt shumë të madh. Gjatë ekskursionit nxënësit vizituan dy qytete të njohura të Turqisë: Stambollin dhe Bursën. Në Stamboll qëndruan pesë ditë, ndërsa në Bursa vetëm dy ditë. Ndërsa, me datë 29 tetor 2018 nxënësit e përfundojnë ekskursionin, dhe kthehen në Kosovë, për ta ruajtur këtë udhëtim në kujtesat e tyre si udhëtimin më të bukur të jetës.



NJË MINUTË HESHTJE PËR DASHURINË

Tri kohët e jetës në kohë dimri po shkrihen
Në prezencë të milionave ndiej vetminë
Një minutë heshtje për të vdekurit që më s'ngrihen
Një minutë heshtje për dashurinë.

*Sa koha ka kaluar, e heshtje mes nesh
Ju lutem, një minutë heshtje për dashurinë
Dashuria nuk qenka edhe aq e mirë
As njeriu s'qenka njeri pa dashurinë.*

*Rinia na bëri të dashuruar
Vrulli më bëri më shumë të besoj
Një minutë heshtje për dashurinë e pushuar
Vetëm një minutë heshtje sot di të shqiptoj.*

*Si duket cilësi e të mençurve qenkësh injorimi
Që unë nuk e cilësova si duhej dikur
Një minutë heshtje për dashurinë
Një minutë heshtje për dashurinë pa kurë.*

*Heshtja është britmë e të dashuruarve
Një minutë heshtje që edhe zjarrin e ngrin
Një minutë heshtje për të dashurit e ndarë
Një minutë heshtje për dashurinë.*

Granit Sadiku

BËHU!

Bëhu si Dielli, që i ndriçon të gjithë dhe kurrë nuk kërkon shpërblim prej të tjerëve!

Bëhu si yjet, që ndriçojnë hapësirën natën vonë kur të gjithë zhduken!

Bëhu si Hëna, që qëndron si mbretëreshë në kupën qiellore, dhe nuk i bëhet vonë se ç'flasin të tjerët për të!

Bëhu si trëndafili, që në vete përmban erën edhe bukurinë, e nëse e prek të lëndon, sepse nuk është mjet ekspozimi!

Bëhu kandil në errësirë, shkëlqej kur të tjerët janë të mbuluar me pluhurin e jetës lakmitare, sepse drita shkëlqen vetëm në errësirë!

Bëhu si shkëmbi! Ai u reziston goditjeve nga më të ndryshmet, mirëpo e lejon që një rrëke uji ta ndaj në dysh.

Bëhu si libri! Ai nuk ulërin, sepse është i heshtur, dhe në të njëjtën kohë flet shumë gjëra.

*Bëhu si bleta! Ajo ulet në qindra lule gjatë gjithë ditës,
dhe nuk e dëmton asnjërin.*

Behu një me kohën! Koha e humbur është krimi më i madh.

Bëhu njeri! Edhe pse sot është e vështirë të jesh njeri në mesin e njerëzve.

Mirvete Karaliti 12/3

LETRARI

Nën tingujt e muzikës
Nën lirin madhështor
Ti e dashur seç më shfaqesh
E më pyet: "më fal, a ke orë?"

"Po, si jo, zonzushë e bukur", - dhe vazhdoj,
"Ora shënon", - dhe vargje recitoj:
"Një dashuri dhe shtatë faje"
"Një shikim dhe shumë orasje"
"Një shtëpi ferri midis parajse"

Ti nuk e di sa është "koha"
Unë nuk e di sa është ora
Me pallavra e filozofi gushti
Të mbaj në këmbë derisa të vijë bora

"Ti qenke i çmendur,
Nga mendja paske fluturuar."
"Epo...", - i them si i lavdëruar:
"Vashë, nga librat mund t'jem harxhuar."

Po, ta dish se veç ti mund të më fyesh,
Dhe vetëm ty mund të të dukem budalla,
Sepse, e di, edhe në të paça, mund të largohesh,
Se për letrarin prezencë përveç vetmisë nuk ka.

Granit Sadiku

MË MBAJ...

Kur sheh thellë në sytë e mi
Të lutem, më trego, çfarë shikon
Vetëm pak ujë i vluar
E di, avull nuk lëshon

Më trego se çfarë jam
Të të tregoj se çfarë ndiej,
Prej se janë vyshkur lulet
Unë gëzim nuk po gjej

Më trego vetëm një ide
Të të mbaj në këtë poezi,
Dikur qemë të gëzuar
E tani jemi në mëri

Më mbaj në kraharor
Të mbështetem e lotët të t'i thaj
Më trego një gjë të bukur
Që të qesh, e jo të qaj

Arita Gashi 10/5

GJYSMA IME

Ti je gjysma ime!
Ti mua më plotëson.
Je fjalë që kurrë nuk mbaron.
Qiri që kurrë nuk fiket.
Ëndërr pa fund.
Tregim pa fillim.
Je syri me të cilin unë shoh.
Je libri që nuk mbyllet.
Koha që shpejt fluturon.
Je ti, gjysma ime, që më plotëson.
E shtrenjta Nënë.

Aida Hashani 11/4

GJITHÇKA PËR TY

*Kërkoj në univers, i marr gjithë planetët dhe t'i jap ty
Nëse ti e kërkon, të gjitha yjet do i ruaj në një kuti me
dry*

*Lulet do ia marr pranverës, e do ta formoj një kurorë
Bizhuteritë e botës që ti t'i kesh në dorë
Ujëvarën e ëndrrave, atë do ta jetosh
Pafundësinë që e kërkoje, do ta shijosh
Syri më nuk do të lotojë, lumturia fytyrën do ta ketë
Perëndimin bashkë do ta shikojmë, për dashurinë e
vërtetë*

*Zogjtë emrin tonë do ta këndojnë, gjithmonë një do të
jemi*

*Kjo histori që e vërtetë, e jo vetëm një ëndërr që thjesht
e themi*

Arita Gashi 10/5

FALËNDERO ZOTIN!

*Kur agon mëngjesi, kur nata mbulon,
Falëndero Zotin, që ty të ndihmon!*

*Kur për natyrën mediton, Hënën kur shikon,
Falëndero Zotin, për sytë që posedon!*

*Kur ta shkelësh tokën, dhe në të rëndon,
Falëndero Zotin, se për Atë ti jeton!*

*Kur me njerëzit e dashur Zoti të begaton,
Falënderoje, se Ai ty të do!*

*Zemrën tënde pastroje, me Mirënjohje e Kuran!
Se ajo është fjala e Zotit, dhe gjallë shpirtin ta mban.*

Medina Mehani 11/4

LULE E VYSHKUR

Fjalë që bart miliona grimca dashurie
Yjet mbi qiell vazhdojnë rrufe të bien
Natë e ditë me probleme kalohen
Në gjumë ëndrra të bukura zgjohen
Zemra si gjithmonë me pikënisje lëndohet
Fillojnë me ëndërr, e me realitet mbarohen
Dashuri sa deti, po valët s'shkumohen
Problemet kaliten, e me to forcohen
Rrëzohesh shpesh në jetë, mendohesh
Por ti je e fortë, e si e fortë s'dorëzohesh
Edhe ditën kur do të dobësohesh.
Edhe atëherë nga shpresa s'tradhtohesh
Mos u mbështet në kohën, ajo është e lirë
Ashtu siç ka ardhur, ashtu do të ikën, pa pikë
Qan, por se ndryshon për më mirë
E mira të kthehet në të keqe, kjo edhe më e vështirë
Symbyllur me mendimin se të gjithë i ke bindur
E rëndë për t'u thënë, dhe e thua pa dëshirë, hidhur
Kur mendon sa muaj e sa vite prite
Në fund vdes, e për çka luftove kurrë s'e dite
Kur mbi zemër të butë e sentimentale
Lundron e rrjedh ndjenja për larg, që s'u fale
Atëherë kur arrin kulmin, të duket tërheqëse
E në fund të lë vetëm, ah sa prekëse
Aromë tunduese mbi trëndafil
E mbloodhi dhe e la si kujtim gafil
Kujton dhe ëndërron një tjetër jetë
Dhe kjo botë e vogël të jep të njëjtën fletë
Të durosh e të jetosh mbi gjembash shumë
Do të thumbohesh, po do të heshtësh, si në gjumë
Ose do të rrënosh kodra e male
Krejt të tradhtojnë, edhe vetja që s'u fale
Po aq e pamundur, po aq e vështirë
T'i harrosh gabimet, dhe që s'bëre mirë
Vjeshtë pas vjeshte, kështu çdo mëngjes
Zë fërshëllyes të tingëllon në vesh
Ndjenjë e humbur, e fshehur mbi agim
Flet edhe para hënës, që sheh në xhamin tim
Prapë një hap më afër se dikur
Prapë tek një derë tjetër, që s'mendove kurrë
Ato një mijë fjalë që i ruajte në mur
Edhe ato sot vëreji, s'janë më si në gur
Shtrëngoj veten prapë, jetën time e mendoj
Lule e vyshkur, jo, s'do të përfundoj
Më mungon bota ime, e plotë me ngjyra shumë
Si buzëqeshja e vulosur që derdhet si lumë.

Sumeja Makolli 10/4

EMBLEMË NË ÇDO KRAHAROR

Në nëntor e nisa jetën
Në fushën e kuqe si gjaku
Me vete e mora të vërtetën
T'i sjellë dritë çdo konaku

Nga dora e plakut mjekërbardhë
Valova në një ballkon shtëpie
Bashkë me trimat e rrallë, të rrallë
U bëra një flamur lirie

E kur vjen nëntori
I shtrij krahët edhe në gur
Jam emblemë në çdo kraharror
E kam emrin shqiponjë n'flamur

Drenusha Gjeli 10/5

ATDHEU IM

Atdheu im nuk është vetëm një tokë e kufizuar me pyje nga të gjitha anët. Ai nuk është asnjë parti politike, e asnjë fjalim pa fjalë.

Atdheu im është nëna ime, duke fshirë lotët në prag të oborrit.

Atdheu im është babai, të cilin nuk e zë gjumi nga brenga se çfarë do hamë nesër.

Atdheu im është im vëlla, të cilin e vrau toka e tij.

Atdheu im janë lotët kur rrezohesha, buzëqeshja ime djallëzore kur bëja ndonjë faj, frymarrja ime kur nuk kishte ajër.

Atdheu im është gjyshja ime, qiriu që digjej duke shqëruar përrallat e saj.

Atdheu im është bindja se në çdo shtëpi, dhe në çdo kohë, gjen një sofër të shtruar me bukë e kripë.

Mirvete Karaliti 12/3

U PËRULEM DUARVE TË MIA

*U përulem duarve të mia
Ua laj vetminë, ua përgjoj gjumin
Ua puth hijet në dërrasë
N'pllëmbën e tyre tronditëse
Një teatër që të përvoëlon*

*U përulem duarve të mia
Që ditën më mbysin herët
E natën ma shkruajnë historinë time*

U përulem duarve të mia

Mirvete Karaliti 12/3

TI DHE UNË

Ti dhe unë ngjajmë...

ngjajmë në mirësi, çiltërsi,

ngjajmë në qetësi.

Ti dhe unë jetojmë

jetojmë duke ëndërruar,

duke shpresuar e dashuruar.

Ti dhe unë kërkojmë...

kërkojmë lirinë, dëlirësinë,

e mbi të gjitha rehatinë.

*Ti dhe unë, nën hijen e ndërmjetësimit
përgjetojmë ndihmën e të Mëshirshmit,*

Madhërishmit.

Xhenetë Krasniqi 10/4

GJYSHJA IME

*Fytyrë të bukur
Dhe rrudha në ballë
Është gjyshja ime
Që shkëlqen si ar*

*Shumë vite të vështira
Mbi supe i ka kaluar
E kujtimet e ëmbla
Si përrallë m'i ka treguar*

*Gjyshja ime e dashur
Më frymëzon shumë
Me fjalët tua të ëmbla
Dhe këshillat si lumë*

Rujejda Mehani 10/5

KURIOZITETE

1. Nëse zgjasim ADN-në tonë, do të ishte e mjaftueshme të sillemi 17 herë rreth Plutonit. Gjenomi i njeriut (kodi gjenetik që gjendet në çdo qelizë njerëzore) përmban 23 molekula të ADN-së, të quajtura kromozome, dhe secila prej tyre përmban 500,000 deri në 2,5 milion çifte nukleotide. Molekulat e ADN-së të kësaj madhësie janë 1,7 deri në 8,5 cm të gjata, e kur janë të pandryshuara - mesatarisht rreth 5 cm. Ka rreth 37 trilion qeliza në trupin e njeriut, kështu që nëse do të hiqim të gjithë ADN-në e mbështjellë në secilën qelizë, dhe t'i vendosim molekulat në fund, do të ketë një gjatësi totale prej 2×10^{14} metra - mjaftueshëm të sillemi 17 herë rreth Plutonit (distanca nga Dielli deri në Pluton, dhe pastaj prapa, është 1.2×10^{13} metra). Si diçka shtesë, e që duhet ta dini, është se secili prej nesh ka 99% të ADN-së tonë të njëjtë me çdo njeri tjetër (kjo vetëm për të treguar se jemi me shumë të ngjashëm sesa të ndryshëm).



2. Një algë ishte gjallesa me e vjetër në botë e njohur, dhe kishte rreth 507 vjet (një kohë shumë e gjatë), mirëpo, për fatin e keq të algës, nuk zgjati më shumë, sepse shkencëtarët e mbyten atë aksidentalisht.



3. Ekzistojnë 8 herë më shumë atome në një lugë çaji me ujë sesa lugë me ujë në tërë Oqeanin Atlantik. Një lugë çaji me ujë (rreth 5ml) përmban 2×10^{23} molekula uji, mirëpo secila molekulë uji përbëhet nga 3 atome: dy atome hidrogjeni, dhe një oksigjeni.



4. Kujdes! Nëse jeni në hapësirë, mos gogësimi në tokë bën, ngase graviteti mban poshtë lëndët e ngurta dhe të lëngshme nga ushqimi që sapo kemi ngrënë, kështu që vetëm gazi ikin nga goja. Në mungesë të gravitetit, gazi nuk mund të ndahet nga lëngjet dhe lëndët e ngurta, kështu që po gogësuar në hapësirë, duhet të keni stomak të fortë, si dhe të dini të pastroni mirë.



5. Floku është një ndër materialet më të forta në botë. Një fije floku e vetme mund të mbajë 100 gram në peshë. Kjo do të thotë që flokët e kombinuar në kokën tuaj, në teori, mund të mbajnë peshën e dy elefantëve, ose 12 ton. Krahasuar me materialet e tjera, flokët e njeriut janë aq të fortë sa kevlar, materiali që përdoret për të bërë xhaketa antiplumb!

6. Numri 7 miliardë nuk është edhe shumë. Ka mbi shtatë miliardë njerëz në Tokë. Tingëllon si shumë?! Krahasuar me numrin e specieve të baktereve që jetojnë në planetin tonë, nuk duket e keqe, mirëpo, sipas një studimi, Toka është shtëpi për një trilion specie të mikrobeve. Megjithatë, vetëm 0.001% është zbuluar. Shkencëtarët tanë me siguri kanë shumë punë për të bërë. Iu dëshirojmë sukses!




7. Sytë janë më të fuqishëm sesa mund ta mendoni. Forma e Tokës është ajo që ia pamundëson syve tanë të shfrytëzojnë potencialin e tyre të plotë. Nëse Toka do të ishte e sheshtë, do të mund të dallonim flakën e një qiriu edhe në largësi prej 48 kilometrash. / Miran Shehu 12/2



LIFE AND PERSONALITY QUOTES

- "The three C's in life: Choice, chance and change. You must make the choice, to take the chance, if you want anything in life to change."
- "The key to success is to focus our conscious mind on the things we desire, not things we fear."
- "Remember that life's greatest lessons are usually learned at the worst times and from the worst mistakes."
- "Every exit is an entry to something. Remember that Columbus was looking for India when he found America."
- "The most important point in life is to accept yourself and stand on your two feet."
- "Always be yourself, express yourself, have faith in yourself, do not look out for a successful personality and duplicate it."
- "Your surroundings may change but your essence and personality pretty much stays the same."
- "Personality has power to uplift, power to depress, power to curse and power to bless." /

Përmbledhi: Alma Azemi 10/5





Klasa 12/1



Klasa 12/2



FJALËFORMIME

E	B	B	O	A	L	F	P	H	K	K	I	E	V	V
LL	Y	E	S	K	K	V	M	T	U	H	O	O	D	G
T	L	O	O	A	F	K	U	Y	I	V	H	I	K	A
K	H	SH	L	I	E	B	A	P	TH	K	F	V	C	T
U	N	F	S	D	L	T	T	I	G	K	Y	GJ	R	S
R	E	T	I	F	P	G	D	K	H	H	O	L	M	GJ
A	T	R	E	K	SH	A	L	B	U	H	GJ	Y	A	T
N	U	Y	R	T	H	S	K	B	G	LL	P	P	T	K
L	S	K	K	P	U	O	SH	I	G	T	H	Y	E	L
H	T	P	S	I	K	O	L	O	GJ	I	SH	U	M	M
E	V	F	P	T	D	SH	O	L	U	D	G	A	A	O
A	T	K	P	XH	E	T	R	O	L	E	K	G	T	ZH
I	N	E	I	T	LL	O	R	GJ	E	K	G	U	I	O
SH	O	O	L	M	B	A	T	I	S	K	R	U	K	T
L	T	E	F	S	I	R	SH	P	T	R	XH	T	Ë	N

Në tabelën e mësipërme gjeni fjalët:

1. Akaid, 2. TIK, 3. Psikologji, 4. Matematikë, 5. Kimi, 6. Biologji, 7. Fikh, 8. Hadith, 9. Tefsir, 10. Kuran.